

Silva Nini Hazir Haziri Zeni Ballazhi

Libër për mësuesin/en

Edukatë figurative 3



Libër për mësuesin/en

Edukatë figurative 3

ISBN: 978-9951-786-90-4



9 789951 786904

BOTIME

pegi

Silva Nini

Hazir Haziri

Zeni Ballazhi

LIBËR PËR MËSUESIN/EN EDUKATË FIGURATIVE 3

Për klasën e tretë të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2023



BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t:
Korrektore letrare: Oriada DAJKO
Paraqitja grafike: Ilmi SHAHU
Kopertina: Elidor KRUJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-786-90-4

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, gusht 2023
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: cel: +355 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

PËRMBAJTJE

ÇFARË SYNON KY LIBËR?.....	4
MODEL I PLANIT VJETOR.....	10
PLANI DYMUJOR: SHTATOR-TETOR	11
PLANI DYMUJOR: NËNTOR-DHJETOR	16
PLANI TREMUJOR: JANAR-SHKURT-MARS	18
PLANI TREMUJOR: PRILL-MAJI-QERSHOR.....	22
PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	27
REFERENCA	102

Çfarë synon ky libër?

Qëllimi i këtij libri është t'i orientojë dhe t'i ndihmojë mësuesit që japin mësim në klasën e tretë, për të përm-bushur synimet e kurrikulës së “Edukatës figurative”, për ndërtimin e kompetencave lëndore dhe kyçe të nxënësit e klasës së tretë, për të planifikuar dhe realizuar detyrat e tyre si mësimdhënës të kësaj lënde, në përputhje me dokumentet zyrtare dhe me fazat nëpër të cilat kalon mësimdhënia.

Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me draft-programin e klasës së tretë, të shkallës së dytë të lëndës “Edukatë figurative”.

Ky libër merr përsipër:

- Të sqarojë çdo mësues/e të “Edukatës figurative” në çështjet e planifikimit ditor, që lidhen me njohuritë dhe veprimtaritë në librin e nxënësit; të metodologjisë dhe të vlerësimit që duhet të zbatohet çdo mësues/e në lëndën e tij/saj;
- Të prezantojë mënyrën se si duhet të përdoren njohuritë, veprimtaritë, rubrikat e librit të nxënësit dhe *Fletorja e punës* nga vetë mësuesi/ja, në lëndën e “Edukatës figurative”;
- Të udhëzojë për format e reja në lidhje me planin ditor dhe situatat e të nxënësit, me të cilat duhet të punojë mësuesi/ja gjatë vitit shkollor. (Theksojmë këtu se “**Plani mësimor** për fusha dhe shkallë të kurrikulës”, “**Plani vjetor** për fusha të kurrikulës”, “**Plani dymujor** për fusha të kurrikulës” dhe “**Plani javor** për fusha të kurrikulës” hartohen nga mësimdhënësit e fushës/fushave të kurrikulës.)¹

Ky libër, në parim jep, ofron ose sugjeron modele, por nuk i dikton ato. Çdo model krijohet mbi një bazë të caktuar të nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim.

Realiteti në çdo klasë mund të sugjerojë modele të ndryshme për tema të caktuara.

Metodologjia e përdorur në ndërtimin e temave/njësive mësimore

Tri aspektet e planifikimit kanë të njëjtën rëndësi për mësuesin/en: **përmbajtja e programit, filozofia** mbi të cilën ngrihet kjo përmbajtje dhe **planet mësimore**, të cilat e bëjnë këtë filozofi dhe përmbajtjen e programit konkrete dhe të realizueshme.

Përdorimi i imazheve është pjesë e rëndësishme e metodologjisë, jo vetëm për të krijuar situatën e të nxënësit, por edhe për të kuptuar më thellë njohuritë e ndryshme. Njësitë mësimore përfshijnë edhe integrimin e fushave të tjera në kurrikulë, siç janë: *Matematika, Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi, Shkencat shoqërore, Shoqëria dhe mjedisi* etj.

Në këtë mënyrë, ju mund t'i integroni këto njësi mësimore në kurrikulën e përgjithshme.

Nëpërmjet njësive të ndryshme mësimore, nxënësit pasurojnë fjalorin, i cili bëhet i kuptueshëm dhe i qëndrueshëm kur njohuritë përsëriten në disa njësi mësimore dhe shoqërohen me veprimtari. Këtë fjalor, nxënësit mund ta përdorin në situata të ndryshme problem-zgjidhjeje edhe në lëndët e tjera.

¹ Sipas “UDHËZUESIT PRAKTIK PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS”, Fusha e kurrikulës artet, Instituti Pedagogjik i Kosovës, mars 2014.

Metodologjia për zhvillimin e lëndës “Edukatës figurative”

Mësimdhënia në “Edukatën figurative” synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet. Ajo mbështetet **në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca; në mësimdhënien me në qendër nxënësin/en; në mësimdhënien dhe nxënien e integruar.**

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit/es, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi, përzgjedhja e strategjive dhe e metodave të mësimdhënies në mësimin e “Edukatës figurative” mban parasysh:

- **Kompetencat kyçe;**
- **Ndërtimin e çdo njohurie dhe çdo aftësie** mbështetur në ato të mëparshmet;
- **Veprimtari praktike krijuese** në edukatën figurative, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet pamore me situata të jetës reale;
- **Mjete dhe materiale** konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- **Krijimin e qëndrimit pozitiv** ndaj lëndës së Edukatës figurative dhe përdorimin e saj përgjatë gjithë jetës;
- **Bashkëveprimin mësues-nxënës** gjatë procesit mësimor, duke qenë plotësues të njëri-tjetrit.

Disa mësimdhënës përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet etj., ndërsa disa të tjerë përqendrohen më shumë te përvoja dhe vëzhgimi, duke inkurajuar e drejtuar nxënësit të kurioziteti ndaj natyrës.

Puna nëpërmjet vëzhgimit ndihmon zhvillimin e vetëdijes vizuale dhe aftësinë për të krijuar e vlerësuar artin në mënyrë individuale. Përvoja e punës me materialet dhe teknikat e artit është e rëndësishme për të arritur rezultatet e dëshiruara të të nxënës. Sigurisht, ato kërkojnë një përgatitje shumë të mirë të mësuesit/es. Të udhëheqësh klasën përmes **zbulimit**, është metoda më e përshtatshme për lëndën e “Edukatës figurative”.

Metoda e zbulimit inkurajon nxënësit:

- Të zbulojnë mundësitë shprehëse të materialeve dhe të teknikave për një qëllim të caktuar dhe të eksperimentojnë me to;
- Të njohin ngjyrën, formën, sipërfaqen etj., në mjedisin rrethues dhe të pëlqejnë interpretimin e tyre, sepse e shohin në mënyrë individuale;
- Të shprehin aspektet më të rëndësishme të jetës së tyre në aspektet figurative.

Në udhëzimet e tij, mësuesi/ja përdor **motivimin** nga ambienti, nxit nxënësit dhe monitoron progresin e tyre, diskuton me ta punët e kryera dhe, nëse është e rëndësishme, kur puna ka mbaruar, bën sugjerimet e nevojshme.

Disa nga format e punës apo metodologjitë, të cilat duhet të udhëheqin mësuesit gjatë punës së tyre janë:

- Eksperienca dhe imagjinata e nxënësve;
- Përdorimi i mjeteve dhe teknikave si nxitje;
- Puna përmes vëzhgimit dhe kuriozitetit;
- Përdorimi i veprave të artistëve ose të nxënësve të tjerë si nxitje.

Mbështetja në eksperiencën dhe në imagjinatën e nxënësve

Është shumë e rëndësishme që ndërtimi i njohurive të reja të mbështetet në përvojën e përditshme, reale të nxënësve. Në këtë vështrim, ata shpesh kanë nevojë për disa forma nxitjeje. Përvojat e të parit, të dëgjuarit ose të prekjes mund t'i nxitin nxënësit të shprehin vizualisht në një rrugë personale. Po ashtu, zhvillimi i aftësive vëzhguese ndikon në mënyrën e të shprehurit. Kur tregojnë për përvojat e tyre, nxënësit portretizojnë veten, familjen, marrëdhëniet me njerëz të afërm dhe gjërat e përditshme që ata bëjnë. Kjo është shumë e rëndësishme, pasi ata vetë janë të përfshirë dhe gjejnë kënaqësi kur përshkruajnë dhe piketojnë situata të ndryshme që ndikojnë në jetën e tyre. Është shumë e rëndësishme të punohet, duke u mbështetur te vëzhgimi, sepse vetëm kështu ata nuk do të turpërohen kur të realizojnë krijimin e tyre pasi e shikojnë vetë nga natyra. Gjithashtu, imagjinata është shumë

e rëndësishme në krijimin e punimeve dy- dhe tredimensionale, pasi nxënësit shfaqin shumë entuziazëm në këtë fushë.

Përdorimi i mjeteve dhe teknikave si nxitje

Përqendrimi te materialet dhe teknikat është një fillim i rëndësishëm për një orë mësimi. Po aq e rëndësishme është gjetja e teknikës së duhur për të ilustruar njohuritë e gjuhës dhe të komunikimit artistik. Por mund të jenë edhe vetë nxënësit që zgjedhin teknikën dhe materialet e duhura për temën mësimore të përcaktuar. Është shumë e rëndësishme që nxënësit nga viti në vit të fitojnë përvoja dhe aftësi në përdorimin e materialeve si dhe të njohin mundësitë e tyre shprehëse. Ata duhet të inkurajohen të flasin për materialet që pëlqejnë më shumë dhe pse.

Puna përmes vëzhgimit dhe kuriozitetit


Nxënësit zbulojnë karakteristikat e botës së tyre fizike në dy mënyra: Duke i parë e duke i prekur objektet nga natyra dhe nëpërmjet zbulimit të karakteristikave të materialeve të artit. Ata vëzhgojnë dhe zbulojnë elementet e artit që gjenden në natyrë, si: ngjyrën, vijën, formën dy- dhe tredimensionale, teksturën (sipërfaqen), hapësirën etj. Ky vëzhgim dhe zbulim do t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë dhe të shprehin në punimet e tyre të artit. Mësuesi/ja dhe klasa e artit duhet të pajisen me ilustrime, koleksione fotografie të objekteve e të fenomeneve nga natyra për nxitjen e veprimtarisë krijuese të nxënësve.

Përdorimi i veprave të artistëve ose të nxënësve të tjerë si nxitje

Të mësosh të "lexosh" për çfarë flet një vepër arti, si është realizuar ajo, cila është domethënia, ndihmon nxënësit të kuptojnë dhe vlerësojnë punën e tyre dhe atë të të tjerëve. Kontakti i menjëhershëm dhe vlerësimi i objektit të artit ose imazhit mund të jetë një pikë e vlefshme për të filluar mësimin e artit. Kështu, nxënësit mund të kenë shumë mundësi për të menduar një sërë temash dhe mënyra punimi, të cilat mund t'i përdorin në punën e tyre. Njohja me stile dhe tradita arti mund t'i ndihmojë ata të krahasojnë interpretimin (punimin) e tyre me veprat ose punime të të tjerëve dhe të shohin veten si pjesë e komunitetit të arpunuesve. Një vepër arti mund të përdoret si stimul për imagjinatën krijuese, dhe jo si një pretekst për të imituar e kopjuar.

Brainstorming (stuhia mendimesh)

Mësuesit mund të përdorin *Brainstorming* si një strategji (metodë) e të menduarit, për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë pyetje, ide dhe shembuj e të zbulojnë një ide apo një temë qendrore (kryesore). Gjatë aplikimit të metodës *Brainstorming*, nxënësit ndajnë idetë që u vijnë në mendje dhe i regjistrojnë këto ide pa bërë gjykime rreth tyre. Mësuesi/ja mund ta përdorë këtë metodë gjatë prezantimit të temës (gjatë situatës së të nxënësve), për të përcaktuar atë që nxënësit dinë dhe duan (ose duhet) të mësojnë dhe për të orientuar zhvillimin e mësimi dhe reflektimin. *Brainstorming* stimulon të menduarit rrjedhshëm e fleksibël. Gjithashtu, mund të përdoret për të aftësuar nxënësit në zgjidhjen e problemeve artistike.



Diskutimi

Diskutimi është një strategji bashkëpunimi, përmes së cilës nxënësit shqyrtojnë mendimin e tyre, reagojnë ndaj ideve, përpunojnë informacionin dhe artikulojnë mendimet duke i shkëmbyer me njëri-tjetrit dhe me mësuesit. Diskutimi mund të përdoret për të qartësuar konceptet, idetë dhe informacionin. Theksi vihet në bisedën dhe dëgjimin e njëri-tjetrit. Nëpërmjet diskutimit, nxënësit mund të krijojnë lidhje midis ideve dhe përvojës. Gjithashtu, mund të reflektojnë mbi interpretime të ndryshme.

Bisedat

Bisedat shoqërojnë pothuajse çdo temë që ka të bëjë me njohuritë dhe punën praktike që shoqëron këto njohuri. Nxënësit duhet të diskutojnë, nën udhëheqjen e mësuesit/es, për punët e tyre dhe të shokëve, si i kanë përdorur elementet e vizatimit me të cilat janë njohur, si i kanë vënë në shërbim të idesë, si i kanë përdorur elementet e tjera që kanë njohur më parë. Si mund ta realizonin më mirë punën e tyre. Të krahasojnë punët e tyre me atë të shokëve.

Të nxjerrin në pah problemet që iu kanë dalë gjatë punës, si i kanë kapërcyer ato ose si duhet ta përmirësojë punën e tyre për të arritur rezultatin e dëshiruar në punimet e tjera etj.

Të gjitha këto konkluzione, nxënësi/ja duhet t'i nxjerrë me ndihmën e mësuesit/es, pasi ai/ajo është udhëheqësi/ja i/e bisedës dhe nxitësi/ja i/e bashkëbisedimit.

Vëzhgimet dhe bisedat rreth tyre

Ashtu si bisedat dhe diskutimet mbi punët që shoqërojnë njohuritë e marra mbi gjuhën artistike, edhe vëzhgimet i shoqërojnë ato, kjo për faktin se të gjitha elementet e artit si vija, forma, ngjyra, tekstura, hapësira etj., e kanë burimin nga natyra, nga objektet dhe dukuritë e saj; zbulimi dhe studimi i tyre është i lidhur ngushtë edhe me shkencat.

Shumë nga këto elemente dhe dukuri në jetën e përditshme kalojnë pa u vënë re nga syri ynë, prandaj është e nevojshme stërvitja e syrit për t'i parë dhe zbuluar ato. Po ashtu, çdo njeri i percepton këto elemente e dukuri sipas mënyrës së vet. Shpeshherë, këto vëzhgime e perceptime janë bërë një bazë e fortë për krijimin e veprave të artit dhe për zbulimin e të rejave shkencore. Nxitja e vëzhgimit duhet të orientohet nga mësuesit në bazë të temave përkatëse.

Është mirë që nxënësi/ja të mbajë një album personal, në të cilin të vendosë materialet ilustruese të gjetura nga vetë ai, pjesë kjo e vëzhgimeve.

Në bazë të këtyre vëzhgimeve ndërtohet edhe diskutimi në klasë, ku nxënësi/ja, në mbështetje të vëzhgimeve të tij/saj dhe materialeve të mbledhura, diskuton dhe arrin vetë në njohjen e elementeve (siguron në bazë të udhëzimeve e shpjegimeve të mësuesit/es), duke arritur kështu në një perceptim më të thellë.

Ekspperimenti

Ekspperimentimi është një metodë thelbësore për artin pamor dhe përdoret shpesh për të bërë lidhjen midis konkretes dhe abstraktes. Ekspperimentimi kërkon që nxënësit të hetojnë, testojnë, eksplorojnë, manipulojnë, zgjidhin problemet, marrin vendime dhe organizojnë informacione në mënyrë praktike. Ekspperimentimi inkurajon gjithashtu nxënësit që të përdorin aftësitë bashkëpunuese në mënyrë efektive në interpretimin dhe komunikimin e gjetjeve. Ekspperimentimi rrit motivimin, mirëkuptimin dhe përfshirjen aktive të nxënësve dhe mund të iniciohet nga mësuesi/ja ose vetë nxënësi/ja.

Puna në grup

Teknikat e punës në grup u mundësojnë nxënësve të punojnë si ekip për të arritur një qëllim të përbashkët mësimi. Për shembull, një grup nxënësish mund të punojnë së bashku për të krijuar një vepër arti ose për të realizuar një projekt artistik. Përveç produktit përfundimtar të përfutur nga grupi, një aspekt i rëndësishëm i procesit të të mësuarit bashkëpunues është që çdo anëtar të shqyrtojë se si funksionon grupi dhe të vlerësojë kontributin e tij/të

saj gjatë procesit të punës në grup. Diskutimet, shënimet dhe vetëvlerësimi janë disa mënyra, në të cilat nxënësit mund të reflektojnë mbi procesin e punës në grup dhe kontributin e tyre në të.

Kujtesa pamore

Kujtesa pamore është një proces që shërben për ta bërë të dukshëm në imagjinatën e nxënësve, një objekt, një ngjarje ose një situatë, duke e ndërtuar nëpërmjet përshkrimit me fjalë ose duke përdorur një imazh. Mësuesit mund të përdorin imazhet gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies, si një ushtrim për kujtesën dhe si një nxitës i rëndësishëm përpara krijimit të punimit. Mësuesit gjithashtu mund të përdorin një sërë stimulimesh pamore (p.sh., ilustrime, fotografi, riprodhime veprash arti, video, objekte reale, grafika) për të ndihmuar nxënësit në krijimin dhe realizimin e punimeve të tyre artistike nëpërmjet teknikave të ndryshme.

Hulumtimi i orientuar

Kjo është një metodë mësimore, në të cilën nxënësit përdorin mjetet dhe materialet sipas zgjedhjes së tyre. Mësuesi/ja vëzhgon dhe dëgjon teksa nxënësit eksplorojnë dhe japin udhëzime sipas nevojës, duke përdorur informacionin e mbledhur nga vlerësimi. Për shembull, mësuesi/ja mund të parashtojë një pyetje që nxit një mendim më të thelluar, ose mund të prezantojë një fjalor të ri.

Hulumtimi i lirë

Ky është një aktivitet kyç i mësimdhënies, që inicohet nga nxënësit duke përdorur materialet artistike në klasë në mënyrat e zgjedhjes së tyre. Mësuesi/ja vëzhgon dhe dëgjon si pjesë të vlerësimit të vazhdueshëm teksa nxënësit eksplorojnë (hulumtojnë) lirisht, dhe nuk e drejton eksplorimin, ashtu siç bën gjatë eksplorimit të orientuar.

Organizuesit grafikë

Organizuesit grafikë mund të përdoren për të regjistruar, organizuar, krahasuar, analizuar dhe sintetizuar informacionet dhe idetë. Ata mund t'i ndihmojnë nxënësit të lidhin njohuritë paraprake me konceptet e reja, si dhe për konsolidimin e kuptimit të tyre.

Disa nga këta organizues grafikë të përshtatshëm për klasën e parë dhe që janë përdorur edhe në planet mësimore janë: harta e mendimeve (kllasteri), reflektimi dhe diagrami i Venit (përdoret gjatë reflektimit).

Gjithashtu edhe teknika *Brainstorming* mund të paraqitet me një organizues grafik, si më lart.

Teknika: Diagrami i Venit

Diagrami i Venit është një teknikë, me anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimi, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to.

Teknika: Kllasteri


Kllasteri ose grupimi i mendimeve apo “harta e mendimeve”, është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, sidomos për ata nxënës që u mungon një dëshirë e tillë.

Hapat për realizimin e kllasterit janë të thjeshtë dhe të lehtë për t'u mbajtur mend:

- Shkruhet një fjalë në qendër të fletës (dërrasës së zezë apo sipërfaqes ku mund të shkruhet).
- Shkruhen fjalë apo fraza që vijnë në mendje rreth kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.

- Formulohen idetë rreth kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.
- Shkrimi i ideve ndërpritet vetëm kur mbaron koha e caktuar. Ndërkohë nxënësit nuk duhet të shqetësohen për gabimet në shkrim apo në shqiptim.

Kjo teknikë mund të përdoret në fazën e evokimit dhe të reflektimit, në të gjitha lëndët dhe me çdo moshë nxënësish. Ai mund të përdoret për të stimuluar të menduarit, përpara se të studiohet pjesa, ose për të bërë përmbledhjen e asaj që është studiuar.



MODEL I PLANIT VJETOR

Fusha e kurrikulës: Arte

Klasa: E tretë

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE					Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës
Lëndët e fushës kurrikulare	Gjysmëvjetori i parë		Gjysmëvjetori i dytë		
	Shtator-tetor 9 orë	Nëntor-dhjetor 8 orë	Janar-shkurt-mars 11 orë	Prill – maj-qershor 9 orë	
Vizatim nëpër kohë (2 orë)	Vizatimi (5 orë) Llojet, teknikat dhe përdorimi i ngjyrave (2 orë)	Piktura (8 orë)	Skulptura-arti në hapësirë (4 orë)	Profesione dhe shkathhtësi kreative (1 orë)	Komunikues efektiv I.3, 6, 7 Mendimi kreativ II.1, 3, 4 Nxënës i suksesshëm III.1, 2, 3, 4, 7 Kontribuues produktiv IV. 5, 2, 6 Individ i shëndoshë V. 5, 7 Qytetar i përgjegjshëm VI. 2, 4, 6
Vizatimi (5 orë)			Format, modelimi dhe skulptura (2 orë)	Projekte dhe shembuj (2 orë)	
			Dizajni dhe grafika (4 orë)	Galeri dhe ekspozime (2 orë)	
			Objekte dhe artefakte (1 orë)	Analiza e punimeve (1 orë)	
				Vlerësimi individual (1 orë)	
				Përkrahimi i punimeve (2 orë)	

PLANI DYMUJOR: SHTATOR-TETOR

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE
LËNDA MËSIMORE: EDUKATË FIGURATIVE
KLASA: III

Tema mësimore: VIZATIM NËPËR KOHË

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT – MENDIMTAR KREATIV

- II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës prej formave shprehëse.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.2 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV

- IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

2. Përmes përjetimit artistik, nxënësit njohin, vërejnë dhe tregojnë elementet kryesore të gjuhës artistike nga fusha përkatëse.

Tema mësimore: VIZATIMI

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I. KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT - KOMUNIKUES EFEKTIV:

- I.7 Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse objekte të natyrës dhe objekte të krijuara nga njeriu, apo ndonjë ngjarje shoqërore, dhe i prezanton para të tjerëve.

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT – MENDIMTAR KREATIV

- II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës prej formave shprehëse.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar, dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
- III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
- III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë, dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
- III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV

- IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.
- VI.4. Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

- V.7. Përkujdeset për një mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.

Nxënësit krijojnë forma të ndryshme dy- dhe tredimensionale duke përdorur teknika të ndryshme figurative dhe aplikative.

Tema mësimore: LLOJET, TEKNIKAT DHE PËRDORIMI I NGJYRAVE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I. KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT - KOMUNIKUES EFEKTIV:

- I.7. Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse objekte të natyrës dhe objekte të krijuara nga njeriu, apo ndonjë ngjarje shoqërore, dhe i prezanton para të tjerëve.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

- IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

- IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT – MENDIMTAR KREATIV

- II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës prej formave shprehëse.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar, dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
- III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
- III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë, dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
- III.7 Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

- IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.
- VI.4 Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

- V.7 Përkujdeset për një mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.

Nxënësit krijojnë forma të ndryshme dy- dhe tredimensionale duke përdorur teknika të ndryshme figurative dhe aplikative.

Tema mësimore: LLOJET, TEKNIKAT DHE PËRDORIMI I NGJYRAVE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I. KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT - KOMUNIKUES EFEKTIV:

- I.7 Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse objekte të natyrës dhe objekte të krijuara nga njeriu, apo ndonjë ngjarje shoqërore, dhe i prezanton para të tjerëve.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV

- IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

PLANI DYMUJOR: SHTATOR - TETOR							
Tema Mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet mjetet dhe materialet
Vizatimi nëpër kohë	Të njohë llojet e vijave dhe të kuptojë përdorimin e tyre në vepra arti;	1. Vija	9 orë	- Bisedë - Diskutim	Buletini i pjesëmarrjes,	Njeriu dhe natyra;	Teksti shkollor
Vizatimi	Të përdorë lloje të ndryshme të vijave për të krijuar figura dhe objekte;	2. Vizatimi		Lojë me role	Portofoli i nxënësit,	Edukatë figurative;	Softuerë arsimorë
Llojet, teknikat dhe përdorimi i ngjyrave	- Të vizatojë së paku një peizazh duke përdorur vijat dhe format e tyre; - Të vizatojë së paku një punim nga objektet (produktet) e ndryshme të natyrës së qetë; - Të skicojë hapësirat e brendshme dhe të vizatojë së paku 1 vizatim sipas objekteve të vendosura në: klasë, shtëpi, teatër, galeri, kinema etj.; - Të skicojë format e figurës së njeriut-portret; - Të shikojë dhe të gjejë iluzionin perceptues në pamjen arkitektonike të një qyteti; - Të identifikojë dhe shpjegojë ngjyrat bazë dhe përzierjen e ngjyrave sekondare.	3. Peizazhi 4. Vizatimi i objekteve të natyrës 5. Vizatimi i një hapësire të brendshme 6. Portreti 7. Qyteti 8. Ngjyrat primare 9. Ngjyrat sekondare		- Diagrami i Venit - Punë në grupe - Punë individuale	Vlerësim i ndërsjellë	- Edukata fizike, sporte dhe shëndeti; - Shoqëria dhe mjedisi; - Gjuhë angleze; - Matematikë; - Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike; - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm; - Zhvillimi personal dhe shkathhtëritë për jetë; - Globalizimi dhe ndërvlerësia - Edukimi për media.	Imazhe ilustruese CD

PLANI DYMUJOR: NËNTOR-DHJETOR

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE
LËNDA MËSIMORE: EDUKATË FIGURATIVE
KLASA: III

Tema mësimore: PIKTURA

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I. KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT - KOMUNIKUES EFEKTIV:

- I.7 Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse objekte të natyrës dhe objekte të krijuara nga njeriu, apo ndonjë ngjarje shoqërore, dhe i prezanton para të tjerëve.

III. KOMPETENCA E TË NXËNËSIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjat, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
- III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
- III.7 Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

IV. KOMPETENCA PËRJETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV

- IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
- IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

- V.5 Bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta, për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

REZULTATET E TË NXËNËSIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.

PLANI DYMUJOR: NËNTOR-DHJETOR						
Tema Mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare
Piktura	- Të kuptoj teknikën e akuarelit dhe të ngjyrosë së paku 2 punime (me ngjyra uji); - Të përdorë ngjyrat dhe të përfitojë efekte tonike në punime; - Të kuptojë teknikën e akuarelit dhe të ngjyrosë së paku 2 punime (me ngjyra uji); - Të krijojë kontrast ngjyash në punime (kolazh, materiale) dhe të dallojë ndryshimet; - Të përdorë ngjyrat nga lapsi dhe flamasterat dhe të përfitojë efekte tonike në punime;	10. Kujtojmë ngjyrat 11. Tonalitetet e ngjyrave 12. Kontrasti i ngjyrave 13. Kontrasti i ngjyrave primare dhe sekondare 14. Teknika e temperës 15. Lapsat me ngjyra 16. Flamasterat 17. Pikturë me akuarel	8 orë	- Bisedë - Diskutim - Lojë me role <i>Brainstorming</i> - Diagrami i Venit - Punë në grupe - Punë individuale	- Buletini i pjesëmarrjes - Portofoli i nxënësit - Vlerësim i ndërsjellë	- Njeriu dhe natyra; - Gjuhë shqipe; - Edukatë figurative; - Edukatë muzikore; - Edukata fizike, sporte dhe shëndeti; - Shoqëria dhe mjedisi; - Gjuhë angleze; - Matematikë; - Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike; - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm; - Zhvillimi personal dhe shkathërsinë për jetë; - Globalizimi dhe ndërvlerësimi; - Edukimi për media.
						Burimet mjetet dhe materialet Teksti shkollor Softuerë arsimorë Imazhe ilustruese CD

PLANI TREMUJOR: JANAR-SHKURT-MARS

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE
LËNDA MËSIMORE: EDUKATË FIGURATIVE
KLASA: III

Tema mësimore: SKULPTURA - ARTI NË HAPËSIRË

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjat, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar, dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
- III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër, për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
- III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë, dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
- III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar, dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

IV. KOMPETENCA PËRJETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV

- IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/ shkollë apo jashtë saj).
- IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

- 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.
- 1.1. Nxënësit krijojnë forma të ndryshme dy- dhe tredimensionale duke përdorur teknika të ndryshme figurative dhe aplikative.

Tema mësimore: FORMA, MODELIMI DHE SKULPTURA

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë, dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
- III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar, dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

- IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.

Tema mësimore: DIZAJNI DHE GRAFIKA**Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:****I-KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT- KOMUNIKUES EFEKTIV**

- I.3. Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
- I.5 Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimi - luajtjes me role, këngës apo vallëzimit.
- I.6. Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe interpreton rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMTAR KREATIV

- II.5 Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast rreziku.
- II.7 Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
- III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
- III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes
- III.7 Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

- IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/ shkollë apo jashtë saj)

- IV.4 Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njëres nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup.
- IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

- 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.

Tema mësimore: OBJEKTE DHE ARTEFAKTE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMTAR KREATIV

- II.4 Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV

- IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/ shkollë apo jashtë saj).
- IV.6 Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta (të shëndetshme) dhe anasjelltas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

- 3. Nxënësi/ja identifikon relacionet e ndryshme të arteve në shoqëri dhe jep shpjegime për to.
- 3.1 Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve duke bërë krahasime dhe përshkrime të thjeshta.

PLANI TREMUJOR: JANAR-SHKURT-MARS							
Tema Mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët tjera mësimore, me çështje ndërkurrikulare	Burimet mjetet dhe materialet
Skulptura-arti në hapësirë	- Të arrijë konkretizim modelimi të një figure gjeometrike me materiale të thjeshta modelimi; - Të krijojë figura simetrike me letër dhe materiale tjera praktike; - Të krijojë një figurë të adhruar me plastelinë nga filmat e animuar sipas personazhit; - Të kuptojë dhe dallojë format sipas madhësisë dhe largësisë (perspektiva-iluzioni i pamjeve nga afër-larg, nga lart-poshtë dhe anasjelltas); - Të dallojë dhe demonstrojë shembuj për përbërjen dhe strukturën e formave (të vrazhdët, valore, të lëmuara, të forta, të buta etj). - Të realizojë një ilustrim sipas një trigrami nga shkrimet, këngët ose filmi të zgjedhur; - Të njohë shenjat (në rrugë, në TV, etj.) dhe të dizenojë 1 punim duke shpjeguar kuptimin; - Të kuptojë artin e shrypit të thjeshtë dhe riprodhimin grafik në shtypshkronjë, p.sh. vula, shrypi me kompjuter, libri, poster etj.	18. Ndërtesa 19. Abazhuri me letër 20. Persona-zhi i preferuar me plastelinë 21. Skulpturë me letër 22. Hapësira 23. Sipërfaqja 24. Ilustrimi i përrallës 25. Simbolet (ora e parë) 26. Simbolet (ora e dytë) 27. Kartolinë për nënën 28. Vendi im i bukur	11 orë	- Bisedë - Diskutim - Lojë me role <i>Brainstorming</i> - Diagrami i Venit - Punë në grupe - Punë individuale	- Buletini i pjesëmarrjes - Portofoli i nxënësit - Vlerësim i ndërsjellë	- Njeriu dhe natyra; - Gjuhë shqipe; - Edukatë figurative; - Edukatë muzikore; - Edukata fizike, - sporte dhe shëndeti; - Shoqëria dhe mjedisi; - Gjuhë angleze; - Matematikë; - Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike; - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm; - Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë; - Globalizimi dhe ndërvlerësia; - Edukimi për media.	Teksti Shkollor Softuerë arsimorë Imazhe të ndryshme ilustruese CD
Format, modelimi dhe skulptura							
Dizani dhe grafika							
Objekte dhe artefakte							

PLANI TREMUJOR: PRILL-MAJ-QERSHOR

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE
LËNDA MËSIMORE: EDUKATË FIGURATIVE
KLASA: III

Tema mësimore: PROFESIONE DHE SHKATHTËSI KREATIVE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMTAR KREATIV

- II.4 Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvlerësinë midis tyre.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV

- IV.2 Kontrollon mjetet/materiallet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/ shkollë apo jashtë saj).

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

2. Përmes përjetimit artistik, nxënësit njohin, vërejnë dhe tregojnë elementet kryesore të gjuhës artistike nga fusha përkatëse.

Tema mësimore: PROJEKTE DHE SHEMBUJ

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMTAR KREATIV

- II.4 Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvlerësinë midis tyre.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUUES PRODUKTIV

- IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/ shkollë apo jashtë saj).

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

2. Përmes përjetimit artistik, nxënësit njohin, vërejnë dhe tregojnë elementet kryesore të gjuhës artistike nga fusha përkatëse.

Tema mësimore: GALERI DHE EKSPOZIME

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

- V.5 Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

- VI.6 Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi; respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke e dëgjuar në mënyrë aktive; vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

3. Nxënësi/ja identifikon relacionet e ndryshme të arteve në shoqëri dhe jep shpjegime për to.
3.2 Kupton rëndësinë dhe llojet e institucioneve artistike.
3.3 Njeh dhe emërton (të paktën 6) krijues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike botërore e kombëtare.

Tema mësimore: ANALIZA E PUNIMEVE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
III. 7 Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

- 4. Nxënësi/ja çmon dhe vlerëson në mënyrë të informuar dhe kritike krijimet artistike individuale dhe të tjerëve.
- 4.1 Shpreh reagimin personal dhe emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjate bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.

Tema mësimore: VLERËSIMI INDIVIDUAL

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
- III.7 Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

- VI.6 Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi; respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke e dëgjuar në mënyrë aktive; vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

- 4. Nxënësi/ja çmon dhe vlerëson në mënyrë të informuar e kritike krijimet artistike individuale dhe ato të tjerëve.
- 4.1 Shpreh reagimin personal dhe emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjate bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.
- 4.2 Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike të tij/saj dhe ato të tjerëve, me fjalor shumë të thjeshtë.

Tema mësimore: PËRSHKRIMI I PUNIMEVE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESSHËM

- III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
- III.7 Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

- VI.6 Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi; respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke e dëgjuar në mënyrë aktive; vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN 2

4. Nxënësi/ja çmon dhe vlerëson në mënyrë të informuar dhe kritike krijimet artistike individuale dhe të të tjerëve.
- 4.1 Shpreh reagimin personal dhe emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjate bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera etj.

PLANI TREMUJOR: PRILL-MAJ-QERSHOR							
Tema Mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët tjera mësimore, me çështje ndërkurrikulare	Burimet mjetet dhe materialet
Objekte dhe arte-fakte	- Njeh dhe dallon objekte të trashëgimisë kulturore (kombëtare dhe të kulturave të tjera); - Njeh disa nga objektet arkitekturore, qilimat, ornamentet, vazot etj.; - Komenton punimet personale dhe i krahason me punimet e tjera në klasë; - Njeh ndonjë krijues (vizatues, piktor, skulptor, - arkitekt etj.), të shquar nga vendi dhe bota; - Përshkruan punimet me shkrim (së paku 2 fjalë); - Komenton dhe krahason vepra të artit dhe punimet e nxënësve; - Përjeton dhe vlerëson në mënyrë personale (së paku 2 punime) - Çmon dhe vlerëson imagjinatën kreative të punimit; - Njeh dhe kupton disa nga institucionet kulturore-artistike (muzeume, galeri, studio, vende arkeologjike etj.); - Realizon një punim për profesionin duke komentuar mënyrën e realizimit; - Shpjegon mënyrën e ndërlidhjes së lëndëve me punimin e realizuar.	29. Profesionin i preferuar 30. Parku i lojërave (ora e parë) 31. Parku i lojërave (ora e dytë) 32. Muzeu Etnologjik, Prishtinë 33. Galeria ime 34. Mikpritja 35. Cirku i lëvizshëm i Aleksandër Kalderit 36. Krahasonimë dy vepra arti 37. Krahasonimë dy vepra arti	9 orë	- Bisedë - Diskutim - Lojë me role - Brainstorming - Diagrami i Venit - Punë në grupe - Punë individuale	- Buletini i pjesëmarrjes - Portofoli i nxënësit - Vlerësim i ndërsjellë	- Njeriu dhe natyra; - Gjuhë shqipe; - Edukatë figurative; - Edukatë muzikore; - Edukata fizike, sporte dhe shëndeti; - Shoqëria dhe mjedisi; - Gjuhë angleze; - Matematikë; - Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike; - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm; - Zhvillimi personal dhe shkathërsitë për jetën; - Globalizimi dhe ndërvlerësia; - Edukimi për media.	Teksti shkollor Softuerë arsimorë Imazhe që ilustronin njohuritë CD
Përshkrim, analiza dhe vlerësimi							
Galeri dhe ekspozime							
Profesioni im kur të rritem							

SHEMBUJ TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 1

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Gjuha dhe komunikimi artistik</i> Tema: Vizatimi nëpër kohë		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Njeh llojet e vijave dhe kupton përdorimin e tyre në vepra arti.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj. IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vija			
Fjalët kyçe: Vija horizontale, diagonale, vertikale; të holla, të trasha, ë vijëzuara; paralele, të harkuara, të valëzuara, zigzage, spirale.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Identifikon lloje të ndryshme të vijave dhe i përdor ato në krijim. - Eksperimenton dhe kombinon llojet e ndryshme të vijave në krijim. - Çmon dhe vlerëson përdorimin në kombinime të larmishme të vijës në krijimin personal dhe në atë të shokëve të klasës. Kriteret e suksesit: - Eksperimenton në flet[n e vizatimit ose n[fletoren e punës me vija diagonale, vertikale, horizontale dhe zigxage; - Kombinon vijat dhe ngjyrat në dekoracione sipas dëshirës.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Edukata figurative 3, imazhe që ilustrojnë mësimin, fletë vizatimi, lapsa me ngjyra ose flamastera, Fletorja e punës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim

Nxënësit identifikojnë llojet e ndryshme të vijave dhe i emërtojnë ato. Më pas ata nxiten të identifikojnë këto lloje vijash edhe në mjedisin përreth. Mësuesi/ja thekson që vija është një element shumë i rëndësishëm për vizatimin.

Ndërtimi i njohurive të reja: eksperimenti, punë në grup

Nxënësit punojnë në grup prej dy vetash. Fleta e ndarë në katër katrorë ndahet në dy për secilin. Çdo nxënës kombinon vijat në formë dekoracioni duke përdorur ngjyra të ndryshme. Më pas, ata i bashkojnë të katërt katrorët në një fletë me ngjyrë dhe i tregojnë si një punë e vetme. Ata mund të eksperimentojnë në fillim në fleta duke u bindur për kombinimet e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit shpjegojnë mënyrën e realizimit dhe kombinimit të vijave dhe ngjyrave me të cilat eksperimentuan dhe krijuan. Ata çmojnë dhe vlerësojnë shumëllojshmërinë e kombinimeve në punën e tyre dhe të shokëve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 2

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Vizatimi		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Përdor lloje të ndryshme të vijave për të krijuar figura e objekte.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.1. Gjen veçoritë (në njërin nga këto aspekte: matematikë, shkenca të natyrës apo fusha të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë; ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë, dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. I.7. Përkshkruan në forma të ndryshme shprehëse objektet natyrore dhe objektet e krijuara nga njeriu, apo ndonjë ngjarje shoqërore, dhe i prezanton para të tjerëve.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vizatimi			
Fjalët kyçe: Vizatimi, vija, lapsi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: • Zbulon se vizatimi është një teknikë shumë e hershme; • Përdor teknikën e vizatimit për të krijuar; • Çmon dhe vlerëson krijimin personal dhe atë të shokëve të klasës. Kriteret e suksesit: • Zgjedh nga revistat dhe pret me gërshërë dy deri në tre figura kafshësh; • Ngjith figurat mbi fletën e bardhë dhe vizaton mjedisin e përshtatshëm.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, ilustrime në përshtatje me temën, Fletorja e punës, mjetet e vizatimit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Artet, Gjuha dhe komunikimi.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim.

Nëpërmjet imazheve nxënësit njihen me pikturat dhe vizatimet e shpellave të periudhës së prehistorisë. Nxënësit identifikojnë motivet e përdorura dhe teknikat e realizimit të tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, bashkëbisedim, punë individuale, hulumtimi i orientuar.

Mësuesi/ja i nxit nxënësit të gjejnë imazhe fotografike të kafshëve të ndryshme (ose mund të përdorin ato që janë dhënë te Fletorja e punës). I orienton t'i presin dhe t'i ngjitin mbi një fletë të bardhë e më pas të vizatojnë mjedisin e tyre të përshtatshëm.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit shpjegojnë mënyrën e realizimit, kafshën që kanë zgjedhur dhe mjedisin e përshtatshëm që kanë vizatuar.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 3

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Vizatimi		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Vizaton të paktën një peizazh duke përdorur vijat dhe format përkatëse.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj. IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Peizazhi			
Fjalët kyçe: peizazh, llojet e ndryshme te vijave, vizatim, ngjyra.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon përdorimin e vijave të ndryshme në imazhe artistike dhe i përdor ato në krijim; • Përdor lloje të ndryshme ngjyrash për një qëllim të caktuar në krijim; • Çmon dhe vlerëson përdorimin e vijave në krijimin personal dhe të shokëve të klasës. Kriteret e suksesit: • Vizaton peizazhin duke përdorur lloje të ndryshme vijash. • Përdor llojet e vijave sipas karakteristikave të objekteve. • Ngjyros sipas dëshirës peizazhin.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Edukatë figurative 3</i> , imazhe që ilustrojnë mësimin, fletë vizatimi, lapsa me ngjyra, pastel, etj.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Nëpërmjet një imazhi artistik “Nata me yje” e Van Gogut, nxënësit ftohen të identifikojnë llojet e ndryshme të vijave që artisti ka përdorur. Përdorimin e tyre në vende specifike në peizazh për një qëllim të caktuar. Më pas, mësuesi/ja i fton nxënësit t’i përdorin këto lloje vijash në fletën e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: punë individuale

Nxënësit nxiten të krijojnë një peizazh duke u mbështetur në veprën e Van Gogut. Mësuesi/ja i orienton të përdorin llojet e ndryshme të vijave në mënyrë të qëllimshme. P.sh. vijat spirale për vorbullat në qiell, vijat e harkuara e të valëzuara për pemët ose malet, vijat e drejta për ndërtesat, etj. Mbasi realizojnë vizatimin nxënësit orientohen të përdorin ngjyrat me zgjedhje sipas dëshirës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit shpjegojnë mënyrën e realizimit dhe përdorimin e vijave me një qëllim të caktuar. Ata çmojnë dhe vlerësojnë shumëllojshmërinë e kombinimeve në punën e tyre dhe të shokëve

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënësi, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve të klasës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra zhvillohet në fletë ose në *fletoren e vizatimit*.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 4

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Vizatimi		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Vizaton së paku një punim nga objektet (produktet) e ndryshme të natyrës së qetë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. V.7. Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vizatimi i objekteve të natyrës.			
Fjalët kyçe: vija, silueta, forma dydimensionale, forma tredimensionale, vizatimi, objekte nga natyra.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon që vija krijon siluetën dhe formën tredimensionale të objekteve; • Përdor vijën për të vizatuar objekte nga natyra; • Çmon dhe vlerëson përdorimin vijave për një qëllim të caktuar në krijimin personal dhe të shokëve të klasës. Kriteret e suksesit: • Vizaton fruta (ose objekte të thjeshta) nga natyra; • Përdor vijën për të vizatuar objektet; • Ngjyros duke përdorur teknikën sipas dëshirës.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Edukatë figurative 3, fletë vizatimi, laps, lapsa me ngjyra ose ngjyra uji.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja i fton nxënësit të vëzhgojnë imazhin fotografik të objekteve nga natyra, Më pas ata vëzhgojnë vizatimin me silueta të objekteve dhe pastaj vizatimin ku shfaqet forma tredimensionale e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, punë individuale

Mësuesi/ja orienton nxënësit të vizatojnë objektet nga natyra dhe të përdorin vijën për të krijuar siluetën e tyre, më pas ata nxiten të vizatojnë detaje të objekteve për të krijuar formën e tyre tredimensionale. Nxënësit zgjedhin edhe teknikën sipas dëshirës për ngjyrosjen e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit shpjegojnë mënyrën e realizimit dhe përdorimin e vijave në vizatimin e tyre. Ata çmojnë dhe vlerësojnë vizatimin e tyre dhe atë të shokëve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra zhvillohet në fletë ose në fletoren e vizatimit.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 5

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Vizatimi		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Skicon hapësirat e brendshme dhe vizaton të paktën 1 vizatim sipas objekteve të vendosura në: klasë, shtëpi, teatër, galeri, kinema etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar, dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. VI.4. Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh.: besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vizatimi i një hapësire të brendshme.			
Fjalët kyçe: lapsi, lapsat me ngjyra, flamastera, <i>Fletorja e punës</i> .			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon karakteristikat e vizatimit të mjediseve të brendshme; • Krijon një hapësirë të brendshme duke përdorur lloje të ndryshme të vijave dhe mjetet e vizatimit; • Çmon dhe vlerëson përdorimin e vijave dhe mjeteve të vizatimit në krijimin personal dhe në atë të shokëve të klasës. Kriteret e suksesit: • Krijon një hapësirë të brendshme duke përdorur lloje të ndryshme vijash. • Përdor mjetet e vizatimit sipas dëshirës (lapsa me ngjyra ose flamastera).			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Edukatë figurative 3, Imazhe ilustruese nga veprat e Matisit.</i>			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Jeta dhe puna, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Nxënësit vëzhgojnë imazhet e pikturave “Dritare e hapur” të Henri Matisit, ku paraqiten brenditë e studiove të tij dhe përshkruajnë brenditë dhe imazhet që shfaqen nga dritaret.

Ndërtimi i njohurive të reja: punë individuale

Mësuesi/ja orienton nxënësit të realizojnë edhe ata brendinë me dritaren e hapur të dhomës në shtëpinë e tyre. (nxënësit mund të përdorin skemën e dhënë të Fletorja e punës). Ata orientohen të përdorin vijat e drejta për muret anësore dhe dritaren, të vizatojnë objektet brenda dhomës dhe peizazhin jashtë dritares. Ata mund të përdorin edhe flamasterat përveç lapsit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit diskutojnë se çfarë kanë paraqitur nga “Dritarja e tyre e hapur” dhe si e kanë realizuar atë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe të *Fletorja e punës*.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 6

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Vizatimi		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Skicon format e figurës së njeriut-portret.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): IV. 5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet. III.1. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar, dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Portreti			
Fjalët kyçe: Vija, vizatimi, portreti.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon përdorimin e vijave në vizatimin e portretit; • Krijon vizatimin e portretit duke përdorur vijat në mënyrën e duhur; • Çmon dhe vlerëson krijimin e tij dhe të shokëve të klasës. Kriteret e suksesit: • Vizaton portretin duke përdorur vijat në mënyrën e duhur. • Ngjyros dhe përdor gjethe ose penj me ngjyra për të plotësuar portretin.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Edukatë figurative 3, laps, letër, pastela ose lapsa me ngjyrë, ngjitës, gjethe, Fletorja e punës.</i>			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Nëpërmjet një imazhi ku paraqitet vizatimi i një portreti nxënësit identifikojnë përdorimin e vijave ndryshme për të krijuar tiparet.

Ndërtimi i njohurive të reja: punë individuale

Mësuesi/ja orienton nxënësit të vizatojnë një portret duke përdorur vijat në mënyrën e duhur. (nxënësit mund të përdorin skemën e portretit të dhënë te Fletorja e punës). Pasi realizojnë portretin me vizatim ata ngjithin gjethet për të krijuar formën e flokëve. Përveç gjethëve, nxënësit mund të përdorin edhe penj me ngjyra sipas dëshirës. Nxënësit përdorin pastelat për të ngjyrosur portretin.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit shpjegojnë mënyrën e realizimit të portretit. Ata vlerësojnë punën e tyre dhe të shokëve të klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 7

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Gjuha dhe komunikimi artistik</i> Tema: Vizatimi nëpër kohë		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Shikon dhe gjen iluzionin perceptues në pamjen arkitektonike të një qyteti.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.1. Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë; ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohej prej tij/saj. IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2. Përmes përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Qyteti			
Fjalët kyçe: qyteti, format gjeometrike, vijat e drejta, fletë vizatimi ose <i>Fletorja e punës</i> , ngjyrat.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon përdorimin e formave gjeometrike dhe vijat e drejta, të përdorura për të krijuar imazhin e një qyte, në një vepër arti; • Përdor vijat e drejta, format gjeometrike dhe ngjyrat për të krijuar imazhin e një qyteti; • Çmon dhe vlerëson krijimin personal dhe atë të shokëve të klasës. Kriteret e suksesit: • Krijon qytetin duke përdorur vijat e drejta dhe format gjeometrike. • Ngjyros me lapsa me ngjyra ose me pastel vizatimin.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Edukatë figurative 3</i> , letër, laps dhe pastela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Matematika, Gjuha dhe komunikimi			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Nxënësit vëzhgojnë veprën “Kështjella dhe dielli” të Pol Klesë, ku paraqitet qyteti nëpërmjet formave gjeometrike dhe vijave të drejta. Mësuesi/ja i inkurajon nxënësit të identifikojnë këto forma dhe ngjyrat e shumëllojshme që ka përdorur artisti.

Ndërtimi i njohurive të reja: punë individuale

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të realizojnë një qytet duke përdorur format gjeometrike, vijat e drejta. Më pas nxënësit e ngjyrosin qytetin e tyre me paste.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit shpjegojnë format, vijat dhe ngjyrat që zgjedhën për qytetin e tyre. Ata çmojnë dhe vlerësojnë edhe punën e shokëve të klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 8

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Gjuha dhe komunikimi artistik</i> Tema: Llojet, teknikat dhe përdorimi i ngjyrave		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Identifikon dhe shpjegon ngjyrat bazë, primare.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.7. Përshtkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu (me të cilin rrethohet), apo ndonjë ngjarje shoqërore, dhe e prezanton para të tjerëve. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2. Përmes përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ngjyrat primare			
Fjalët kyçe: ngjyrat primare (e verdha, e kuqja dhe e kaltra).			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - Dallon ngjyrat primare në mjedisin që e rrethon; - Përdor kombinimin e ngjyrave primare dhe të formave të thjeshta në krijim; - Vlerëson mënyrën e kombinimit të ngjyrave primare dhe të formave në krijimin e tij/saj dhe të shokëve të klasës. Kriteret e suksesit: - Vizaton kuadratë duke përdorur vijat e drejta. - Ngjyros duke kombinuar ngjyrat primare.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Edukatë figurative 3</i> , imazhe që ilustrojnë ngjyrat primare, fletë e bardhë ose Fletorja e punës, lapsa me ngjyra ose flamastera.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Matematika, Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja u tregon nxënësve imazhe që ilustrojnë ngjyrat bazë. Nxënësit ftohen të identifikojnë ngjyrat dhe të japin shembuj të tjerë të objekteve apo fenomeneve që kanë ngjyrat bazë.

Ndërtimi i njohurive të reja: punë individuale, demonstrim

Mësuesi/ja shpjegon se ngjyrat bazë ose të para quhen kështu pasi prej tyre krijohen ngjyrat e tjera.

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të realizojnë një krijim dekorativ duke përdorur kombinimin e ngjyrave të para dhe të formës së katrorit. Mësuesi/ja orienton nxënësit të shikojnë pikturën me tri ngjyrat primare të Mondrianit. Mondriani kombinon kuadrate të madhësive të ndryshme dhe i ndan me vija të zeza të dukshme. Më pas, mbi to kombinon ngjyrën e kuqe, të kaltër dhe të verdhë. Nxënësit ftohen të plotësojnë me këto ngjyra kuadratet e dhëna në *Fletoren e punës*, e po ashtu mund t'i kompozojnë edhe vetë kuadratet e më pas t'i ngjyrosin duke kombinuar ngjyrat primare.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësi/ja shpjegon se ka përdorur ngjyrat bazë dhe kombinimin e tyre në krijimin

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënësi, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 9

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Gjuha dhe komunikimi artistik</i> Tema: Llojet, teknikat dhe përdorimi i ngjyrave		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Identifikon dhe shpjegon ngjyrat bazë, si dhe përzierjen e ngjyrave sekondare.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.7. Përkshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik, nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ngjyrat sekondare			
Fjalët kyçe: ngjyrat primare, ngjyrat sekondare (e gjelbër, portokalli, vjollcë), ngjyra uji			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - Realizon ngjyrat sekondare nëpërmjet përzierjes së ngjyrave primare; - Përdor ngjyrat e ujit për të plotësuar rrethin e ngjyrave; - Shpjegon mënyrën e plotësimit të rrethit të ngjyrave. Kriteret e suksesit: - Përzien ngjyrat primare për të krijuar ato skondare. - Vendos ngjyrat primare dhe sekondare në rrethin e ngjyrave. - Përdor ngjyrat e ujit për të plotësuar rrethin e ngjyrave.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Edukatë figurative 3, ngjyra uji (tempera ose akuarele), skema e ngjyrave te Fletorja e punës.</i>			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të bëjnë gati ngjyrat e ujit, penelin, gotën e ujit dhe letër. Mësuesi/ja i orienton të përziejnë të verdhën me të kaltrën, dhe ata zbulojnë vetë ngjyrën e gjelbër. Më pas, ata përziejnë të verdhën dhe të kuqen dhe zbulojnë ngjyrën portokalli. Në fund, nxënësit përziejnë ngjyrën e kaltër me të kuqe dhe zbulojnë ngjyrën vjollcë. Pra, çfarë ndodh kur përziejme ngjyrat primare?

Ndërtimi i njohurive të reja: hulumtim i lirë, punë individuale

Mësuesi/ja shpjegon që ngjyrat primare mund të përzihen për të krijuar ato sekondaret. Mësuesi/ja i orienton nxënësit të plotësojnë skemën e rrethit të ngjyrave dhe të krijojnë figuracione me të. Nxënësit ndjekin udhëzimet nëpërmjet eksperimentit me ngjyrat.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: kllasteri, diskutimi

Pasi plotësojnë rrethin me ngjyrat primare dhe sekondare, nxënësit shpjegojnë mënyrën e realizimit të rrethit dhe figuracionet që përdorën.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënë, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 10

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Piktura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Kupton teknikën e akvarelit dhe ngjyros të paktën 2 punime (me ngjyra uji).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.7. Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik nxënësit njohin (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kujtojmë ngjyrat.			
Fjalët kyçe: lapsat me ngjyra, ngjyrat e ujit, peneli, gota.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Përdor ngjyrat e ujit dhe mjetet e duhura për të përzier ngjyrat; • Eksperimenton me sasinë e ngjyrave në përzierje; • Vlerëson mënyrën e kombinimit të ngjyrave në eksperimentin e tij/saj dhe të shokëve të klasës. Kriteret e suksesit: • Eksperimenton me përzierjen e ngjyrave. • Eksperimenton me sasinë e ngjyrave në përzierje.			

Shënim: Ky mësim nuk pasqyrohet në librin e nxënësit, me qëllim realizimin në mënyrë të pavarur të eksperimentit të tyre me ngjyrat.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Edukatë figurative 3, imazhe që ilustrojnë mjetet e ngjyrave të ujit, fleta e modeluar, ngjyra uji, penel, gotë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Nëpërmjet imazheve të mjeteve të punës nxënësit diskutojnë për mënyrat e përdorimit të penelit, të ujit dhe të ngjyrave.

Ndërtimi i njohurive të reja: Eksperimenti, demonstrim

Mësuesi/ja shpjegon se nëpërmjet ngjyrave të ujit mund të realizojmë përzierje të ndryshme të ngjyrave. Tretja e tyre në ujë e bën më të lehtë edhe përzierjen mes tyre. Mësuesi/ja i orienton nxënësit të eksperimentojnë me përzierjen e ngjyrave. Në fillim ata shtrydhin ngjyrën e verdhë në pjatë dhe ngjyrosin. Më pas i shtojnë të verdhës në pjatë pak të kuqe dhe ngjyrosin një hapësirë tjetër. Shtojnë më shumë të kuqe dhe ngjyrosin përsëri. Në këtë mënyrë ata eksperimentojnë me përzierjen e ngjyrave.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit shpjegojnë se cili ishte rezultati i punës së tyre. Ata kuptojnë që me ndryshimin e sasisë së ngjyrës ndryshon edhe vetë ngjyra. Ata çmojnë e vlerësojnë edhe punën e shokëve të klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:**Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:**

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra zhvillohet në fletë ose në fletoren e vizatimit.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 11

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Piktura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Përdor ngjyrat dhe përfiton efekte tonike në punime; - Kupton teknikën e akvarelit dhe ngjyros të paktën 2 punime (me ngjyra uji).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). V.5. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Tonalitetet e ngjyrave			
Fjalët kyçe: Tonalitetet e ngjyrave, ngjyra uji			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon që ngjyrat kanë tonalitete të ndryshme; • Realizon tonalitete të ndryshme të ngjyrave nëpërmjet përzierjes së tyre; • Shpjegon se përzierja e ngjyrave në sasi të ndryshme krijon tonalitete të ndryshme. Kriteret e suksesit: • Realizon tonalitetet e ngjyrave nëpërmjet përzierjes së tyre. • Përdor ngjyrat e ujit për të realizuar tonalitetet e ngjyrave.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Edukatë figurative 3, imazhe që ilustrojnë tonalitetet e ngjyrave, Fletorja e punës, ngjyra uji.</i>			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja tregon tri lloje të ndryshme të portokallisë, të së gjelbrës, të vjollcës, dhe i fton nxënësit që t'i emërtojnë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë individuale, eksperimenti

Mësuesi/ja shpjegon se ngjyrat e shfaqura janë në tonalitete të ndryshme. Nëpërmjet eksperimentit, do të zbulojnë se, duke përzier sasi të ndryshme të dy ngjyrave, krijohen tonalitete të ngjyrës. Mësuesi/ja i orienton për të krijuar tonalitetet e ngjyrave.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit diskutojnë për mënyrën e realizimit të tonaliteteve të ngjyrës. Ata vlerësojnë dhe diskutojnë së bashku duke ndarë mendimet dhe duke respektuar njëri-tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 12

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Piktura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Krijon kontrast ngjyrash në punime (kolazh, materiale) dhe dallon ndryshimet.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). V.5. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kontrasti i ngjyrave			
Fjalët kyçe: Kontrasti i ngjyrave.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon që kontrasti i ngjyrave është i rëndësishëm për të dalluar objektet; • Krijon një dekoracion me forma gjeometrike duke përdorur kontrastin e ngjyrave; • Shpjegon cili nga kontrastet i pëlqen më shumë dhe pse. Kriteret e suksesit: • Pret dy shirita letre, njërën me ngjyrën vjollcë. • Pret katrorë me ngjyrat primare dhe sekondare (dy herë) dhe i ngjit. • Bën dallimin midis kontrasteve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Edukatë figurative 3</i> , imazhe që ilustrojnë kontrastin e ngjyrave, letër me ngjyra (ose flamastera), laps, gërshtë, ngjitës, <i>Fletorja e punës</i> .			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Shkencat shoqërore, Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Puna dhe jeta			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja tregon një pikturë të Endi Uorhol, ku paraqiten katër lule me ngjyra të ndryshme mbi një fushë me bar të gjelbër. Mësuesi/ja i pyet nxënësit se cila prej luleve është më e dukshme se të tjerat?

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë individuale

Mësuesi/ja shpjegon se piktori ka vendosur lulet me ngjyra të ndryshme mbi një fushë të errët. Lulja që ka ngjyrën me më shumë dritë, bëhet edhe më e dukshme për syrin tonë. Aty ku kontrasti midis objektit dhe sfondit është më i dukshëm edhe objekti bie më shumë në sy. Mësuesi/ja i orienton nxënësit të realizojnë një kolazh dekorativ me forma gjeometrike dhe me kontraste ngjyrash. Në Fletoren e punës është përgatitur skema ku ata mund të punojnë me letra me ngjyra ose me mjetet e vizatimit.

Ata gjejnë se cili kombinim krijon kontrastin më të mirë të ngjyrave.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit diskutojnë për mënyrën e realizimit dhe kontrastin e ngjyrave që krijuan. Ata vlerësojnë dhe diskutojnë së bashku duke ndarë mendimet dhe duke respektuar njëri-tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 13

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Piktura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Krijon kontrast ngjyrash në punime (kolazh, materiale) dhe dallon ndryshimet.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kontrasti i ngjyrave primare dhe sekondare			
Fjalët kyçe: kontrasti i ngjyrave.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon që kontrasti i ngjyrave është dallimi midis dy ngjyrave; • Eksperimenton dhe realizon ushtrime me kontraste të ngjyrave plotësuese (primare dhe sekondare); • Shpjegon cili nga kontrastet i pëlqen më shumë dhe pse. Kriteret e suksesit: • Zgjedh çiftet e ngjyrave plotësuese. • Eksperimenton me kontrastin e ngjyrave plotësuese. • Realizon ushtrimin te fletorja e punës, duke përdorur kontrastin e ngjyrave plotësuese.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, <i>Fletorja e punës</i> , flamastera.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja shfaq një imazh që tre lloje të kontrasteve. Ai/ajo i fton nxënësit të shikojnë dhe të zbulojnë që çiftet e ngjyrave aty janë primare dhe sekondare.

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë individuale, hulumtim i orientuar

Mësuesi/ja shpjegon se kontrasti është dallimi midis dy ngjyrave si në një vepër arti ashtu edhe në mjedisin që na rrethon. Mësuesi/ja orienton nxënësit të emërtojnë çiftet e ngjyrave dhe shpjegon se këto çifte ngjyrash plotësojnë njëra-tjetrën dhe krijojnë një kontrast të fortë mes tyre. Nxënësit orientohen të plotësojnë skemën e dhënë në fletoren e punës me çiftet e ngjyrave plotësuese.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit diskutojnë për kontrastin e ngjyrave plotësuese dhe kombinimin që u pëlqen më shumë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënë, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 14

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Piktura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Kupton teknikën e ngjyrave të ujit dhe ngjyros të paktën 2 punime.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Teknika e temperës			
Fjalët kyçe: peneli, ngjyra uji (tempera), mjetet e punës, tavaloca.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon karakteristikat e veçanta të teknikës së temperës; • Krijon tavalocën e piktorit duke ndjekur udhëzimet e duhura; • Shpjegon mënyrën e realizimit dhe të përdorimit të tavalocës. Kriteret e suksesit: • Krijon tavalocën me pjatë prej letre dhe me prerjen e duhur. • Vendos ngjyrat në tavalocë dhe i përdor në mënyrën e duhur.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Edukatë figurative 3</i> , tempera, penela, gotë me ujë, pjata prej letre, gërshtë, ngjitës.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Puna dhe jeta			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Nxënësit diskutojnë për ngjyrat e ujit dhe karakteristikat e tyre, duke u mbështetur në eksperiencat e mëparshme me teknikën e akualetit.

Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, eksperimenti

Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e ngjyrave të temperës, dallimet dhe të përbashkëtat dhe ngjyrat e akualetit. Mësuesi/ja shpjegon mjetet e punës, ndër to edhe tavalocën. Ai/ajo i orienton nxënësit të krijojnë një tavalocë duke ndjekur disa hapa.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Kllasteri, diskutimi

Në fund të orës së mësimit nxënësit shpjegojnë si e krijuan tavalocën dhe demonstrojnë si përdoret ajo.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 15

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Piktura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Përdor ngjyrat e lapsit dhe flamasterat; - përfiton efekte tonike në punime.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Lapsat me ngjyra			
Fjalët kyçe: lapsat me ngjyra, goma, letra, mprehtësia.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon karakteristika të veçanta të teknikës së lapsave me ngjyra; • Krijon duke përdorur teknikën e lapsave me ngjyra; • Shpjegon mënyrat e përdorimit të lapsave me ngjyra. Kriteret e suksesit: • Vizaton me laps një temë sipas dëshirës. • Përdor teknikën e lapsave me ngjyra për krijimin e tij/saj.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, <i>Fletore pune</i> ose letër e bardhë, lapsa me ngjyra, imazhe ilustruese.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Artet, Gjuha dhe komunikimi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Nëpërmjet imazheve nxënësit nxiten të flasin për teknikën e lapsave me ngjyra. Ata diskutojnë për karakteristikat e teknikës dhe eksperiencat e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, punë individuale

Mbas diskutimit për disa mënyra të përdorimit të lapsave nxënësit ftohen të realizojnë një krijim me këtë teknikë. Nxënësit nxiten që të provojnë dhe eksperimentojnë në punimet e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Diskutimi

Kur mbaron puna, nxënësit diskutojnë mbi karakteristikat e lapsave me ngjyra dhe mënyrën e ngjyrosjes që kanë përdorur punimet e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 16

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Piktura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Përdor ngjyrat nga lapsi e flamasterat dhe përfiton efekte tonike në punime.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Flamasterat			
Fjalët kyçe: flamasterat			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon karakteristika të veçanta të teknikës me flamastera. • Krijon duke përdorur teknikën e flamasterave. • Shpjegon mënyrat e përdorimit të flamasterave. Kriteret e suksesit: • Krijon kristalet me teknikën e flamasterave. • Përdor ngjyrat sipas dëshirës.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, <i>Fletorja e punës</i> , flamastera.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja shfaq një vizatim me flamastera dhe i pyet nxënësit se me çfarë është realizuar. Ai/ajo i fton nxënësit/et të shikojnë dhe të zbulojnë karakteristikat e punës me teknikën e flamasterave.

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë individuale, hulumtim i orientuar

Mësuesi/ja shpjegon shjeron se flamasterat janë mjete mjaft të pëlqyeshme në krijim. Ata përbëhen nga maja dhe nga një depozitë që mban ngjyrën e lëngët. Majat mund të jenë me forma dhe përmasa të ndryshme. Më pas i fton nxënësit të punojnë me flamastera në fletoren e tyre të punës për të realizuar kristalet me ngjyra.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit/et diskutojnë për mënyrën se si i realizuan kristalet e tyre dhe për karakteristikat e teknikës me flamastera.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënë, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 17

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Piktura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Kupton teknikën e akvarelit dhe ngjyros të paktën 2 punime (me ngjyra uji).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Pikturë me akvarele			
Fjalët kyçe: ngjyra uji, akvarele.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon që akvarelet janë ngjyra uji; • Përdor akvarelet në krijim; • Shpjegon mënyrën e përdorimit të akvareleve në krijim. Kriteret e suksesit: • Vizaton rrathë të ndryshëm të brendashkruar. • I ngjyros me teknikën e akvarelit duke i kombinuar ngjyrat sipas dëshirës.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, akvarele			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja i fton nxënësit të vëzhgojnë veprën e artistit Kandinski. Ai/ajo i fton nxënësit të identifikojnë format gjeometrike dhe ngjyrat që ka përdorur artisti në veprën “Rrathët brenda katrorëve”.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, eksperimenti

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të krijojnë duke imituar stilin e ngjyrave të Kandinskit. Ata orientohen të ndjekin hapat duke filluar që nga vizatimi e deri te përzgjedhja e kombinimi i ngjyrave.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur mbaron puna, nxënësit u tregojnë pikturën e tyre abstrakte sipas Kandinskit dhe mënyrën e realizimit. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 18

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Skulptura – arti në hapësirë		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Arrin konkretizim modelimi të një figure gjeometrike me materiale të thjeshta modelimi.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjte, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë, dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ndërtesa			
Fjalët kyçe: Ndërtesa, piramida, kuboidi, forma, modelimi, ngjyrat.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - Përdor mjetet e vizatimit për të krijuar pjesët përbërëse të ndërtesës (dritare, dyer, ngjyra, etj.); - Pret me gërshërë modelin dydimensional në Fletoren e punës (piramidën dhe kuboidin) dhe realizon me ngjitje piramidën për çatinë dhe kuboidin për trupin e ndërtesës; - Shpjegon mënyrën e realizimit të ndërtesës me letër. Kriteret e suksesit: - Vizaton dhe ngjyros pjesët përbërëse të ndërtesës. - Pret me gërshërë modelin nga fletorja e punës. - Palos dhe ngjit piramidën dhe kuboidin për të krijuar ndërtesën.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Edukatë figurative 3, fleta e modeluar, laps, flamaster ose lapsa me ngjyra, gërshtë, ngjites.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të shohin imazhin e ndërtesave në libër. I pyet nxënësit se çfarë forme gjeometrike kanë ndërtesat.

Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, punë individuale

Mësuesi/ja orienton nxënësit të presin piramidën dhe kubin nga Fletorja e punës. Ai/ajo i orienton t'i palosin dhe t'i ngjitin në mënyrën e duhur. Të shtojnë elementet e tjerë si, dritare e dyer, etj. në fund nxënësit e përfundojnë shtëpinë duke i ngjitur të dyja pjesët bashkë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Nxënësit diskutojnë për dallimin midis formës dydimensionale dhe asaj tredimensionale, si dhe mbi mënyrën e realizimit të ndërtesës. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:**Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:**

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënë, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 19

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Skulptura – arti në hapësirë		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Krijon figura simetrike me letër dhe materiale të tjera praktike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Llamba ptrej letre			
Fjalët kyçe: Forma tredimensionale, gjatësi, gjerësi dhe thellësi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Kupton dallimin midis formës dy- dhe tredimensionale; • Eksperimenton dhe krijon formën tredimensionale nëpërmjet modelimit të letrës ose kartonit; • Shpjegon mënyrën e realizimit të formës tredimensionale. Kriteret e suksesit: • Përgatit me prerje letrën për llambën. • Krijon formën tredimensionale të llambës.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, letra me ngjyra (ose karton), gërrshërë, vizore, laps, ngjitës			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja shfaq imazhin e llambave, të cilat janë krijuar prej letrave me ngjyra.

Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, eksperimentim

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se si të krijojnë llambën duke ndjekur hapat. Ndërkohë që mësuesi/ja shpjegon dhe demonstroi hap pas hapi mënyrën e ndërtimit të abazhurit. Nxënësit ndjekin hapat dhe realizojnë llambën e tyre. (Nxënësit mund të përdorin modelin e dhënë në Fletoren e punës.)

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur mbaron puna nxënësit i vendosin llambat së bashku në një fije. Kjo është një mënyrë e bukur për të zbukuruar mjediset në raste festash. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 20

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Skulptura - arti në hapësirë		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Krijon një figurë të adhuruar me plastelinë nga filmat e animuar sipas personazhit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohej prej tij/saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Skulpturë me plastelinë			
Fjalët kyçe: Personazh, plastelinë, skulpturë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Përdor plastelinën në krijim; • Modelon plastelinën për të krijuar pjesët përbërëse të personazhit të preferuar; • Shpjegon mënyrën e realizimit të personazhit nëpërmjet plastelinës me ngjyra. Kriteret e suksesit: • Përgatit dhe modelon plastelinën. • Krijon një personazh me plastelinë (pinguini).			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, plastelinë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Shkencat natyrore, Matematika			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të shohin skulpturat e realizuara nga skulptorja dhe piktorja franceze Niki de San Fal dhe i nxit të shpjegojnë si janë paraqitur elefanti dhe qeni. I pyet ata se kush është personazhi i tyre i preferuar në filmat vizatimorë me kafshë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, hulumtim i lirë

Mësuesi/ja shpjegon se figura e elefantit dhe e qenit janë realizuar nëpërmjet teknikës së modelimit të plastelinës. Modelimi është një teknikë e realizimit të skulpturës. Pas shpjegimit të teknikës së modelimit, i fton nxënësit të ndjekin hapat për realizimin e personazhit. Pasi realizojnë personazhin e pinguin-it, mësuesi/ja i nxit ata të krijojnë personazhet e tyre të preferuara me plastelinë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Nxënësit diskutojnë për personazhet që zgjedhën dhe për mënyrën e realizimit. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënësi, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 21

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Skulptura – arti në hapësirë		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Krijon figura simetrike me letër dhe materiale të tjera praktike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Skulpturë me letër			
Fjalët kyçe: forma gjeometrike, personazhi, simetria.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Përdor për të krijuar një figurë simetrike; • Realizon me letër personazhin që i pëlqen më shumë; • Shpjegon mënyrën e realizimit të objektit dhe trupin (ose trupat) gjeometrikë që përdori. Kriteret e suksesit: • Vizaton në letër dhe pret me gërshërë pjesët e personazhit. • Palos, modelon dhe ngjit letrën për të krijuar personazhin.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, letër me ngjyra, laps, gërshërë, letër, ngjitës			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi, Matematika			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të shohin skulpturat e zogjve të realizuar me letër, dhe i fton ata të zbulojnë se me çfarë materiali janë realizuar.

Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, hulumtim i lirë

Mësuesi/ja shpjegon se skulpturat e zogjve janë realizuar nëpërmjet modelimit të letrave me ngjyra. Për të krijuar skulpturat me letra mund të përdoren teknika, si: prerja, palosja, rrotullimi dhe ngjitja. Mësuesi/ja i fton nxënësit të ndjekin hapat për realizimin e personazhit. I orienton të kuptojnë simetrinë e personazhit. Nxënësit vizatojnë pjesët e personazhit në letra me ngjyra dhe pastaj i ngjitin sipas udhëzimeve të mësuesit/es.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Nxënësit diskutojnë për personazhin që krijuan, për format gjeometrike, për simetrinë dhe për ngjyrat që zgjedhën. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënë, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 22

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Gjuha dhe komunikimi artistik</i> Tema: Format, modelimi dhe skulptura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): - Të kuptojë dhe dallojë format sipas madhësive dhe largësisë (perspektiva-iluzioni i pamjeve nga afër-larg, nga lart-poshtë dhe anasjelltas);	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2. Përmes përjetimit artistik, nxënësit njohin, vërejnë dhe tregojnë elementet kryesore të gjuhës artistike nga fusha përkatëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Hapësira			
Fjalët kyçe: larg, afër, vija e horizontit, pika e ikjes.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon paraqitjen e trupave në hapësirë nëpërmjet perspektivës; • Realizon trupa gjeometrikë në hapësirë duke përdorur perspektivën me një pikë ikjeje; • Shpjegon vijën e horizontit dhe pikën e ikjes në figurë. Kriteret e suksesit: • Vizaton vijën e horizontit dhe pikën e ikjes. • Vizaton 2 figura gjeometrike poshtë dhe sipër vijës së horizontit. • Krijon trupat gjeometrikë me ndihmën e vijave dhe pikës së ikjes.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, laps, letër, vizore, gomë, ngjyra			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja i fton nxënësit në një situatë konkrete: Imagjinoni veten duke qëndruar në anën e një rruge. Një makinë po vjen drejt jush nga një distancë e largët. Ndërsa makina afrohet, bëhet më e madhe. Pra, objektet më afër nesh do të jenë më të mëdha, kurse ato më larg, më të vogla.

Ndërtimi i njohurive të reja: Demonstrim, punë individuale

Mësuesi/ja i fton nxënësit të vëzhgojnë kubet e dhëna në figurë dhe mënyrën se si janë paraqitur. Ai/ajo shpjegon se kubet janë paraqitur në hapësirë nëpërmjet përdorimit të perspektivës me një pikë. Çdo kub ka largësi të ndryshme nga syri ynë. Faqen e parë të çdo kubi, e shohim me brinjë të barabarta, ndërsa brinjët dhe faqet e tjera të kubeve, duken gjithnjë e më të vogla, duke u larguar drejt pikës së ikjes. Perspektiva është një mjet që artistët e përdorin për të krijuar hapësirën në veprat e tyre të artit. Më pas i nxit nxënësit të eksperimentojnë me perspektivën. Nxënësit ndjekin hapat e demonstruara nga mësuesi/ja për të paraqitur dy trupa gjeometrikë në hapësirë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur mbaron puna, nxënësit shpjegojnë si i realizuan trupat gjeometrikë në hapësirë, shpjegojnë vijën e horizontit dhe pikën e ikjes. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve të klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënësi, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 23

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Gjuha dhe komunikimi artistik</i> Tema: Format, modeli dhe skulptura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Dallon dhe demonstroi shembuj për përbërjen dhe strukturën e formave (të vrazhda, valore, të lëmuara, të forta, të buta etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): IV.5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë. III.7. Identifikon njohuritë që ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2. Përmes përjetimit artistik, nxënësit njohin, vërejnë dhe tregojnë elementet kryesore të gjuhës artistike nga fusha përkatëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Sipërfaqja			
Fjalët kyçe: shenja, tekstura, sipërfaqja.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Kupton që shenjë që përsëritet krijon sipërfaqen; • Krijon sipërfaqe të ndryshme nëpërmjet përsëritjes së shenjave në krijim; • Shpjegon sipërfaqen që ka krijuar dhe ngjyrat që ka përdorur. Kriteret e suksesit: • Vizaton një peizazh me elementet përbërëse të tij. • Krijon tekstura të larmishme nëpërmjet përsëritjes së shenjave.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, fleta vizatimi, laps, flamastera			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja shfaq disa imazhe me sipërfaqe natyrore dhe artificiale dhe i fton nxënësit të vëzhgojnë dhe identifikojnë elementin apo shenjën që përsëritet. Mësuesi/ja i pyet nxënësit: A e krijon sipërfaqen kjo përsëritje?

Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim i lirë, punë individuale

Mësuesi/ja i orienton nxënësit, të krijojnë një peizazh në vizatim. Për çdo hapësirë të peizazhit ata orientohen të përdorin një shenjë dhe ta përsërisin atë brenda kësaj hapësire. Më pas të përdorin flamasterat për të ngjyrosur sipërfaqet e krijuara.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Diskutimi,

Kur mbaron puna, nxënësit shpjegojnë mënyrën e realizimit të sipërfaqeve në peizazhin e tyre. Ata vlerësojnë edhe punën e shokëve të klasës

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 24

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Dizajni dhe grafika		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Realizon një ilustrim sipas një tregimi, kënge apo filmi të zgjedhur.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Identifikon personazhet (subjektet) kryesore të një veprë arti, p.sh.: tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është e përshtatshme për moshën, dhe realizon një subjekt të ngjashëm në punimin e tij/saj. I.3. Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup, në një kohëzgjatje prej 3-5 minutash. III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar, dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. III.4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë, dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ilustrim i përrallës			
Fjalët kyçe: veçantia e artistit figurativ, ilustrimi i përrallës.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - Bisedon mbi karakteristikat e veçanta të çdo artisti në krijim; - Krijon ilustrimin e përrallës në mënyrë personale; - Zbulon që çdo artist është i veçantë dhe çdo krijim është ndryshe nga tjetri. Kriteret e suksesit: - Zgjedh një moment nga përralla që i pëlqen më shumë. - Përdor mjetet sipas dëshirës për ilustrimin e tij/saj.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, imazhe të veprave të artistëve, fletë vizatimi, laps, lapsa me ngjyra ose flamastera.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**Fusha:** Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Artet**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim**

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se çdo artist figurativ e shikon mjedisin përreth në një mënyrë të ndryshme dhe pasi e realizon veprën e tij e ndan atë me të tjerët. Në këtë mënyrë tërheqin vëmendjen tonë nëpërmjet ngjyrave, forma dhe na ndihmojnë t'i shohim gjërat në një mënyrë të re ose më të mirë.

Mësuesi/ja fton nxënësit të vëzhgojnë ilustrime të përrallës "Gomari, qeni, macja dhe gjeli" të realizuara nga artistë të ndryshëm. Mësuesi/ja i fton nxënësit të tregojnë se si e kanë paraqitur artistët figurativë këtë përrallë.

Ndërtimi i njohurive të reja: punë individuale, hulumtimi i orientuar

Mbas kësaj bisede, mësuesi/ja shpjegon se çdo artist është i veçantë dhe për këtë arsye punimet e tyre edhe pse janë shumë të bukura, janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Ato janë të ndryshme edhe nga mjetet që përdorin.

Mësuesi/ja i nxit nxënësit të realizojnë ilustrimin e përrallës "Gomari, qeni, macja dhe gjeli". Ai/ajo i orienton ata të paraqesin një moment nga përralla që u pëlqen më shumë dhe të zgjedhin edhe mjetet artistike për ta realizuar atë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur puna ka mbaruar, nxënësit ngrenë lart punimet e tyre për të parë punimet e njëri-tjetrit dhe komentojnë që ata të gjithë kanë bërë një punë shumë të mirë. Çdo nxënës ka realizuar një moment të caktuar të përrallës dhe e ka bërë atë në mënyrën e tij të veçantë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:**Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:**

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 25

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Dizajni dhe grafika		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Njeh shenjat (në rrugë, në TV etj.) dhe dizenjon 1 punim duke shpjeguar kuptimin e tij	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.4. Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër; përshkruan pozitat që zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvlerësinë midis tyre. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në një material tjetër, për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. II.5. Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast rreziku.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Simbolet (ora e parë)			
Fjalët kyçe: shenjat, simbolet, komunikimi, orientimi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - Zbulon rëndësinë e shenjave dhe simboleve në komunikim. - Realizon shenja dhe simbole të ndryshme. - Shpjegon se çfarë kuptimi kanë simbolet që ka realizuar. Kriteret e suksesit: - Krijon simbole me kafshët. - Shkruan kuptimin e simbolit, duke u nisur nga karakteristikat e kafshës që ka vizatuar.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, imazhe simboleve dhe kuptimi i tyre, mjete vizatimi.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi, Puna dhe jeta

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja shfaq disa imazhe simbolesh të ndryshme dhe i fton nxënësit të shpjegojnë se çfarë kuptimi kanë ato.

Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, punë individuale

Pasi mbaron bashkëbisedimi me nxënësit, mësuesi/ja shpjegon se që në kohët e hershme, simbolet kanë shërbyer si një mënyrë për të komunikuar idetë. Mësuesi/ja i nxit nxënësit të krijojnë simbole me kafshët. Ata duhet të shkruajnë edhe kuptimin e këtyre simboleve, nisur nga karakteristikat e kafshëve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur mbaron puna, nxënësit shpjegojnë kuptimin e simboleve me kafshë që krijuan. Ata vlerësojnë edhe punën e shokëve dhe shoqeve të klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënë, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 26

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Dizajni dhe grafika		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Njeh shenjat (në rrugë, në TV etj.) dhe dizenjon 1 punim duke shpjeguar kuptimin e tij.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.4. Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër; përshkruan pozitat që zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvlerësinë midis tyre. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në një material tjetër, për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. II.5. Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërin nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast rreziku.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Simbolet (ora e dytë)			
Fjalët kyçe: shenjat, simbolet, komunikimi, orientimi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon rëndësinë e shenjave dhe simboleve në komunikim dhe orientim. • Realizon shenja dhe simbole të ndryshme. • Shpjegon se çfarë kuptimi kanë simbolet që ka realizuar. Kriteret e suksesit: • Krijon dhe vizaton simbole që mund të përdoren në media. • Shkruan kuptimin e simbolit që ka krijuar.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, imazhe të simboleve, mjete të vizatimit.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore, Matematika, Gjuha dhe komunikimi, Puna dhe jeta

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, hulumtimi i lirë

Në fillim të orës, nxënësit diskutojnë për shenjat dhe simbolet që përdoren në mediat sociale.

Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grup

Mësuesi/ja shpjegon se sot, simbolet kanë një përdorim të gjerë: në libra, në mediat sociale, vende publike etj. Nëpërmjet tyre shkëmbejmë shpejt dhe me lehtësi ide që mund t'i kuptojnë të gjithë, pavarësisht nga gjuha që flasin. Mësuesi/ja i orienton të realizojnë simbole dhe të shkruajnë kuptimin e tyre. Nxënësit përdorin mjetet e vizatimit për të realizuar simbolet e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur mbaron puna, nxënësit shpjegojnë kuptimin e simboleve që krijuan. Ata vlerësojnë edhe punën e shokëve dhe shoqeve të klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 27

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Krijimtaria dhe performanca artistike</i> Tema: Dizajni dhe grafika		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Kupton artin e shtypit të thjeshtë dhe riprodhimin grafik në shtypshkronjë, p.sh.: vula, shtypi me kompjuter, libri, poster etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash. I.5. Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimi - luajtjes me role, këngës apo vallëzimit. II.7. Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna. III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. VI.4. Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh.: besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1. Nxënësit krijojnë forma artistike duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të artit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kartolinë për nënën			
Fjalët kyçe: kartolinë, urim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - Përdor njohuritë artistike dhe gjuhësore për të realizuar një kartolinë urimi; - Realizon një kartolinë me temë “Kartolinë për Ditën e Nënës”; - Shpjegon mënyrën e realizimit të kartolinës. Kriteret e suksesit: - Përdor shkrimin në kartolinën e nënës. - Palos dhe ngjyros me teknikë sipas dëshirës kartolinën.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Edukatë figurative 3, letër, laps, gërrshërë, flamastera.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat shoqërore, Gjuha dhe komunikimi, Puna dhe jeta, Artet

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja i fton nxënësit të diskutojnë për Ditën e Nënës dhe të japin mendimin e tyre për realizimin e një kartoline urimi për të.

Ndërtimi i njohurive të reja: punë individuale

Mësuesi/ja i fton nxënësit të realizojnë një kartolinë urimi për nënën. Nxënësit orientohen të shkruajnë emrin “Nënë” dhe më pas të zbukurojnë çdo gërmë me motive dhe ngjyra sipas dëshirës. Pasi mbarojnë, ata e presin kartolinën dhe e palosin në katër pjesë për të qëndruar në këmbë në formë zigzage.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur mbaron puna, nxënësit diskutojnë së bashku për mënyrën e realizimit të kartolinës, ngjyrat dhe motivet që zgjedhën.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënë, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 28

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Relacioni art-shoqëri</i> Tema: Objekte dhe artefakte		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Njeh dhe komunikon për objektet e rëndësishme të trashëgimisë kulturore (kombëtare dhe të kulturave të tjera); - Kupton rëndësinë e vlerave të artit kombëtar dhe kujdesin që tregohet për to.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.4. Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër; përshkruan pozitat që zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvlerësinë midis tyre. IV.2. Kontrollon mjetet/materialët dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). IV.6. Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta (të shëndetshme) dhe anasjelltas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në një material tjetër, për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3. Nxënësi/ja identifikon relacionet e ndryshme të arteve në shoqëri dhe jep shpjegime për to.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kosova, vendi im i bukur			
Fjalët kyçe: poster, vendet turistike, monumentet kulturore, objektet me vlera artistike dhe kulturore, vepra arti etj.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Mbledh imazhe nga vendet turistike, monumentet kulturore, objektet me vlera artistike dhe kulturore, vepra arti etj.; • Realizon një poster ose një album me temë “Vendi im i bukur” me imazhet e mbledhura; • Shpjegon mënyrën e realizimit të posterit dhe vendet turistike e artistike të Kosovës, qytetit apo fshatit. Kriteret e suksesit: • Mbledh fotografi me imazhe nga monumentet e kulturës dhe të natyrës në Kosovë. • Krijon një album duke i renditur dhe ngjitur fotografitë.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Edukatë figurative 3, tabakë letre, imazhe, gërshtë, ngjitës, flamastera.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat shoqërore, Shkencat natyrore, Gjuha dhe komunikimi, Puna dhe jeta, Artet

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja i fton nxënësit të paraqesin imazhet e mbledhura nga vende historike, kulturore, monumente, vepra arti etj., nga Kosova, qyteti apo fshati, që ata i kanë mbledhur. Ata diskutojnë së bashku për këto vende apo monumente.

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, bisedë, punë në grup

Mësuesi/ja i fton nxënësit të realizojnë një poster me imazhet e gjetura dhe ta quajnë “Vendi im i bukur”. Ai/ajo u shpjegon nxënësve se është shumë e rëndësishme të njohim vendin tonë, bukuritë dhe historinë e tij dhe ta mbrojmë dhe reklamojmë atë. Në fillim nxënësit përzgjedhin imazhet më të mira, i presin dhe i ngjitin në tabakë të mëdha letre. (Në varësi të numrit të nxënësve mund të realizohen dy ose më shumë postera në mënyrë që të gjithë të përfshihen në këtë veprimtari). Poshtë imazheve nxënësit shkruajnë vendin dhe emrin e monumentit përkatës. Gjithashtu ata vendosin edhe titullin e posterit “Vendi im i bukur”.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur mbaron puna, nxënësit diskutojnë së bashku për vendet e bukura në Kosovë, në qytetin apo fshatin e tyre, ku ndodhen ato e nëse i kanë vizituar ndonjëherë prej tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:**Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:**

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënësi, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 29

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Gjuha dhe komunikimi artistik</i> Tema: Profesione dhe shkathtësi kreative		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Me teknikë të lirë kreative, realizon 1 punim për profesionin e adhuruar duke komentuar mënyrën e realizimit dhe përdorimin praktik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.4. Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër; përshkruan pozitat që zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në një material tjetër, për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2. Përmes përjetimit artistik, nxënësit njohin, vërejnë dhe tregojnë elementet kryesore të gjuhës artistike nga fusha përkatëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Profesioni i preferuar			
Fjalët kyçe: profesioni, mjetet e punës.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon profesione të ndryshme dhe rëndësinë e tyre në shoqërinë njerëzore; • Realizon një vizatim mbi profesionin e tij/saj të dëshiruar; • Shpjegon profesionin që përzgjedhi dhe detyrat që ka ky profesion. Kriteret e suksesit: • Vizaton veten me karakteristikat e profesionit të preferuar. • Përdor mjetet sipas dëshirës për ta ngjyrosur.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, imazhe të profesioneve të ndryshme, mjetet e realizimit sipas dëshirës			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore, Shoqëria dhe mjedisi, Matematika, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi, Artet, Edukata fizike, sportet dhe shëndeti

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *Brainstorming*, Kujtesa pamore

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën “Profesionet” dhe nxënësit e plotësojnë me emrat e profesioneve që ata njohin. Më pas mësuesi/ja shfaq disa imazhe nga profesione të ndryshme dhe fton nxënësit të diskutojnë se cilat janë detyrat e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, punë individuale

Mësuesi/ja i pyet nxënësit se çfarë kanë dëshirë të bëhen kur të rriten dhe i fton ata të vizatojnë veten, në të ardhmen, në rolin e profesionit që u pëlqen më shumë.

Mësuesi/ja shpjegon se është e rëndësishme që ata të njohin:

- detyrat që ka ky profesion;
- mjedisin e punës;
- veshjen e duhur;
- mjetet e nevojshme të punës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur mbaron puna, nxënësit shpjegojnë për profesionin që kanë zgjedhur dhe si si e kanë paraqitur atë në krijimin e tyre. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve dhe shoqeve të klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:**Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:**

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 30

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Relacioni art-shoqëri</i> Tema: Projekte dhe shembuj		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Dizenjon një ide vizatimore për një park me lodra fëmimore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.4. Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër; përshkruan pozitat që zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvlerësinë midis tyre. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3. Nxënësi/ja identifikon relacionet e ndryshme të arteve në shoqëri dhe jep shpjegime për to.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Parku i lojërave (ora e parë)			
Fjalët kyçe: parku i lojërave, mjedisi, forma, ngjyra.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Identifikon formën dhe funksionin e lojërave të parkut; • Realizon një nga lodrat e parkut në mënyrë kreative; • shpjegon mënyrën e realizimit të lodrave. Kriteret e suksesit: • Përgatit mjetet e punës. • Pret, ngjit dhe palos letrat me ngjyra për të krijuar lodrat.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore Edukatë figurative 3, imazhe të parkut të lojërave			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat shoqërore, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja shfaq imazhet nga parqe të ndryshme lojërash për fëmijë. Ata diskutojnë për llojet e ndryshme të lojërave, format dhe funksionin e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, punë në grupe

Nxënësit ndahen në grupe dhe zgjedhin lodrën që do të realizojnë. Ata ndajnë punën, mbledhin mjetet, skicojnë idetë e tyre dhe ndërtojnë lodrën që zgjodhën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Diskutimi

Kur mbaron puna, nxënësit shpjegojnë mënyrën e realizimit të lodrave. Ata vlerësojnë edhe punimet e shokëve dhe shoqeve të klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 31

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Relacioni art-shoqëri</i> Tema: Projekte dhe shembuj		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Dizenjon një ide vizatimore për një park me lodra fëmimore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.4. Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre. IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3. Nxënësi/ja identifikon relacionet e ndryshme të arteve në shoqëri dhe jep shpjegime për to.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Parku i lojërave (ora e dytë)			
Fjalët kyçe: parku i lojërave, mjedisi, forma, ngjyra.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - Identifikon formën dhe funksionin e lojërave të parkut; - Realizon një park lojërash në miniaturë; - shpjegon mënyrën e realizimit të parkut të lojërave. Kriteret e suksesit: - Bashkëpunon me shokët dhe shoqet. - Organizojnë bashkërisht parkun.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, imazhe të parkut të lojërave			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat shoqërore, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Nxënësit diskutojnë së bashku për realizimin e parkut, vendin, idenë dhe materialet që do të përdorin.

Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, punë në grupe

Nxënësit grumbullojnë të gjitha lodrat e realizuara dhe fillojnë ti organizojnë në një park. Ata kujdesen për rrugët që t'i lidhin ato me njëra-tjetrën dhe hapësirat e gjelbra.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur mbaron puna, nxënësit shpjegojnë mënyrën e realizimit të parkut dhe të mjedisit që e rrethon.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënë, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 32

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Relacioni art-shoqëri</i> Tema: Galeri dhe ekspozime		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Njeh dhe kupton disa nga institucionet kulturoro-artistike në vend (muze, galeri, studio, vende arkeologjike etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.3. Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit. V.5. Bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj. VI.6. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi; respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke e dëgjuar në mënyrë aktive; vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3. Nxënësi/ja identifikon relacionet e ndryshme të arteve në shoqëri dhe jep shpjegime për to.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Muzeu etnologjik, Prishtinë			
Fjalët kyçe: ekspozitë, muze arti, galeri arti, artist.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon se vendi ku ekspozohen objekte dhe veshje që tregojnë mënyrë e jetesës quhet Muze etnologjik; • Parashtron pyetje për mënyrën se si ekspozohen objektet dhe veshjet në muzeun etnologjik; • Shpreh mendimin e tij për muzetë etnografikë. Kriteret e suksesit: • Merr pjesë aktive në vizitën e muzeut etnologjik. • Parashtron pyetje në lidhje me objektet e ekspozuara.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, imazhe të objekteve të muzeut etnologjik Prishtinë.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *Kujtesa pamore, diskutime*

Mësuesi/ja shfaq imazhe nga shtëpia e Muzeut Etnologjik të Prishtinës. I pyet nxënësit për karakteristikat e shtëpisë dhe për objektet e ekspozuara aty.

Ndërtimi i njohurive të reja: **Bisedë, kujtesa pamore**

Mësuesi/ja jep informacionin mbi Muzeun Etnologjik të Prishtinës, për ndërtesën dhe periudhën kur është ndërtuar. Shpjegon se muzetë etnologjikë janë institucione kulturore që ekspozojnë dhe mbledhin objekte dhe tregojnë për mënyrën e jetesës në periudha të ndryshme. Mësuesi/ja flet për koleksionin e pasur të muzeut dhe i fton nxënësit që ta vizitojnë atë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: **Diskutimi**

Në fund të orës, nxënësit shprehën për karakteristikat e objekteve të ndryshme që janë pjesë e muzeut. Ata diskutojnë nëse kanë ndonjë të tillë, ende në shtëpitë e tyre. Ata bëjnë edhe krahasimin mes objekteve të muzeut me objektet që përdoren sot, për të kuptuar ndryshimin në mënyrën e jetesës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënë, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 33

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Relacioni art-shoqëri</i> Tema: Galeri dhe ekspozime		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Njeh dhe kupton disa nga institucionet kulturoro-artistike në vend (muze, galeri, studio, vende arkeologjike etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.3. Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit. V.5. Bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj. VI.6. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi; respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke e dëgjuar në mënyrë aktive; vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3. Nxënësi/ja identifikon relacionet e ndryshme të arteve në shoqëri dhe jep shpjegime për to.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Galeria ime			
Fjalët kyçe: ekspozitë, muze arti, galeri arti, artist figurativ.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Zbulon se vendi ku artistët ekspozojnë veprat e tyre janë kryesisht muzetë dhe galeritë e artit; • Parashtron pyetje për mënyrën se si ekspozohen veprat në një galeri arti; • Krijon galerinë personale me vepra të artistëve figurativë shqiptarë dhe të huaj. Kriteret e suksesit: • Mbledh fotografi të veprave të artit. • I rendit dhe i ngjit për të krijuar galerinë personale.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, imazhe të galerive të artit, imazhe të veprave të artistëve të ndryshëm			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *Brainstorming*

Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë fjalën “artist” dhe i fton nxënësit të japin idetë dhe perceptimin e tyre mbi këtë fjalë. Mësuesi/ja vendos rreth fjalës “artist” të gjitha fjalët që fëmijët i lidhin me të, pa paragjykuar asnjërën. Ndër to mund të jenë fjalët: piktor, skulptor, këngëtar, krijues, aktor, dizajn etj. Më pas, mësuesi/ja i fton nxënësit të diskutojnë për vendet ku ekspozohen veprat e artit.

Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, kujtesa pamore

Mësuesi/ja shpjegon se muzetë dhe galeritë e artit janë institucione kulturore që ekspozojnë dhe mbledhin vepra arti të artistëve të ndryshëm. Mësuesi/ja iu shpjegon se është e rëndësishme të vizitojmë galeritë e artit, për të njohur nga afër punën e artistëve dhe karakteristikat e veprave të tyre. Mësuesi/ja i fton nxënësit të krijojnë edhe ata një galeri personale, duke vendosur nëpër hapësirat e caktuara fotografi të veprave të artistëve të ndryshëm. Poshtë fotografisë, ata duhet të vendosin emrin e artistit dhe titullin e veprës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Në fund të orës, nxënësit shpjegojnë përse janë të rëndësishme galeritë e artit. Nxënësit tregojnë galerinë që kanë krijuar dhe veprat e artistëve që kanë vendosur aty.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 34

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik</i> Tema: Analiza e punimeve		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Bisedon dhe analizon krijimet e realizuara në klasë dhe ato të artistëve të njohur (së paku 2 punime).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.1. Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar, dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. III.2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër, për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 4. Nxënësi/ja çmon dhe vlerëson në mënyrë të informuar dhe kritike krijimet artistike individuale dhe ato të të grupit			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Mikpritja			
Fjalët kyçe: ngjarje historike, artisë të njohur shqiptarë, simbole kombëtare, veshje kombëtare.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - Njeh piktorin Adem Kastrati dhe karakteristikat e veprës së tij “Mikpritja”; - Vizaton duke përdorur elemente nga vepra si frymëzim; - Diskuton për traditën e mikpritjes dhe për veshjet tradicionale. Kriteret e suksesit: - Vizaton një personazh të veshur me tirqe. - Ngjyros personazhin me mjetet e vizatimit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukatë figurative 3, imazhi i veprës “Mikpritja”, lapsa me ngjyra.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat shoqërore, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore, bashkëbisedim

Mësuesi/ja shfaq imazhin e veprës “Mikpritja”, të artistit Adem Kastrati, ose i referohet imazhit në libër dhe shpjegon që kjo është një vepër që i kushtohet një tradite me shumë vlera të shqiptarëve. Mësuesi/ja i fton nxënësit të vëzhgojnë me vëmendje veprën dhe drejton pyetje: Ku zhvillohen ngjarjet? Përshkruani mjedisin. Çfarë po bëjnë personazhet? Si janë të veshur personazhet në pikturë?

Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë, diskutime, punë individuale

Mësuesi/ja jep një informacion të përgjithshëm për piktorin Adem Kastrati dhe për karakteristikat e veprës së tij. Më pas mësuesi/ja shpjegon përmbajtjen e veprës, traditën shqiptare të mikpritjes dhe sesi paraqitet kjo në pikturë. Mësuesi/ja i fton nxënësit të vëzhgojnë personazhet që paraqiten të veshur me veshje tradicionale si: tirqit dhe plisi. Mësuesi/ja i nxit nxënësit të vizatojnë një personazh të veshur me veshje tradicionale.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur mbaron puna, nxënësit shpjegojnë se si e realizuan personazhin dhe e krahasojnë me ato që janë paraqitur në pikturën e artistit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 35

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik</i> Tema: Vlerësimi individual		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Përjeton në mënyrë individuale punimet nga veprat e njohura dhe bën vlerësimin estetik sipas përjetimit; - Çmon dhe vlerëson imagjinatën kreative tek punimet vizuale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.3. Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit. III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. VI.6. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi; respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke e dëgjuar në mënyrë aktive; vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Shpreh reagimin personal dhe emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimike, me mjete shprehëse të tjera etj. 4. 2. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetjake dhe ato të të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë (p.sh.: ai/ajo këndoi mirë, pastër; më pëlqejnë ngjyrat që ke përdorur; nuk e ke vizatuar mirë formën e topit etj.).			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Cirku i lëvizshëm i Aleksandër Kalderit			
Fjalët kyçe: skulptura të lëvizshme, cirku.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • Vëzhgon vepra arti dhe përshkruan çfarë sheh në to; • Realizon një skulpturë të lëvizshme duke u mbështetur te veprat e artistit Kalder; • Vlerëson veprën e artit, punimin e tij dhe të shokëve të klasës. Kriteret e suksesit: • Bashkëpunon në grup në mënyrë aktive. • Vizaton, ngjyros dhe pret figurën e zgjedhur. • I vendosin bashkërisht me grupin në një varëse.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Edukatë figurative 3, imazhet e veprave të artit të skulptorit Kalder

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shkencat natyrore, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, përshkrimi

Mësuesi/ja shfaq imazhet nga veprat e artistit Aleksandër Kalder, cirkun dhe skulpturat e lëvizshme. I fton nxënësit të vëzhgojnë me kujdes detajet dhe i orienton t'i krahasojnë me njëra-tjetrën.

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, punë në grup

Mësuesi/ja shpjegon se artisti Aleksandër Kalder ishte shumë i njohur për skulpturat e tij të lëvizshme. Ndër punët e tij të para është një cirk me tela, i cili i kujtonte argëtimet e fëmijërisë. Në punët e mëvonshme, ai përdori forma të ndryshme dhe tela për të krijuar skulpturat e tij të lëvizshme. Në skulpturat e tij, ai paraqet kafshë ose objekte. Mësuesi/ja i fton nxënësit të realizojnë edhe ata një cirk të lëvizshëm. Nxënësit ndahen në grupe. Zgjedhin të vizatojnë nga një kafshë secili (ose ndonjë figurë tjetër). Ata vizatojnë dhe ngjyrosin figurën e zgjedhur mbi një letër kartoni, nga të dyja anët. E presin me gërshërë dhe bëjnë nga një vrimë në pjesën e sipërme të saj. Lidhin një fije spangoje në vrimën e hapur. Përdorin një varëse rrobash prej teli, në formë rrethore, për të varur figurat e kafshëve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Kur mbaron puna, nxënësit shpjegojnë se si e realizuan cirkun e tyre të lëvizshëm, figurat që zgjedhën dhe vlerësojnë punën e grupeve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe të analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 36

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik</i> Tema: Përshkrimi i punimeve		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Përshkruan 2 punime nga artistë të njohur të fushave të ndryshme, si: pikturë, skulpturë dhe dizajn, duke zgjeruar përshkrimin sipas përshtypjeve.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.3. Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit. III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. VI.6. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi; respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke e dëgjuar në mënyrë aktive; vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2. Shpreh reagimin personal dhe emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimike, me mjete shprehëse të tjera etj. 4. 2. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetjake dhe ato të të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë (p.sh.: ai/ajo këndoi mirë, pastër; më pëlqejnë ngjyrat që ke përdorur; nuk e ke vizatuar mirë formën e topit etj.).			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Krahason dy vepra arti ²			
Fjalët kyçe: përshkrim, krahasim, vepra arti.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - Vëzhgon dy vepra arti dhe përshkruan çfarë sheh në to; - Analizon dhe krahason elementet e subjektit që paraqesin veprat e artit; - Vlerëson veprat duke renditur karakteristikat e veçanta dhe ato të përbashkëta. Kriteret e suksesit: - Përshkruan dhe krahason atë që sheh te dy vepra arti. - Rendit karakteristikat e veçanta dhe të përbashkëta të dy veprave të artit.			

2 Ky model mësimi, me rrugën metodike që ndjek, shërben për të krahasuar dy punime të nxënësve në klasë apo edhe vepra të tjera të artit

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Edukatë figurative 3, imazhet e dy veprave të artit që kanë elemente të përbashkëta të subjektit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, përshkrimi

Mësuesi/ja shfaq imazhet e dy veprave që kanë karakteristika të përbashkëta të subjektit. Në libër janë marrë si shembull: “Tre muzikantët”, 1921, e artistit Pablo Pikaso dhe “Muzikantët e xhazit”, 1982, e artistit Geri Erbe. Nxënësit ftohen të përshkruajnë subjektin e veprës së artit, pra atë që është e dukshme, nëpërmjet pyetjeve orientuese të mësuesit/es.

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, analiza dhe krahasimi

Mësuesi/ja rendit të gjitha të dhënat e vëzhgimeve duke krijuar një listë. Mësuesi/ja ndërton në tabelë diagramin e Venit dhe i fton nxënësit të përzgjedhin dhe të vendosin karakteristikat e veçanta dhe të përbashkëta. Këtë detyrë nxënësit e realizojnë në *Fletoren e punës*.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: vlerësimi, diagrami i Venit

Në fund të orës, nxënësit lexojnë ndarjen e karakteristikave të veçanta dhe të përbashkëta. Më pas i diskutojnë me njëri-tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 37

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Edukatë figurative	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: III
<i>Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik</i> Tema: Përshkrimi i punimeve		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Nxënësi/ja: - Përshkruan 2 punime nga artistë të njohur të fushave të ndryshme, si: pikturë, skulpturë dhe dizajn, duke zgjeruar përshkrimin sipas përshtypjeve.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.3. Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit. III.7. Identifikon njohuritë e veta, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. VI.6. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi; respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke e dëgjuar në mënyrë aktive; vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2. Shpreh reagimin personal dhe emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimike, me mjete shprehëse të tjera etj. 4.2. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetjake dhe ato të të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë (p.sh.: ai/ajo këndoi mirë, pastër; më pëlqejnë ngjyrat që ke përdorur; nuk e ke vizatuar mirë formën e topit etj.).			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Krahasojmë dy vepra arti ³			
Fjalët kyçe: përshkrim, krahasim, vepra arti.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - Vëzhgon dy vepra arti dhe përshkruan çfarë sheh në to; - Analizon dhe krahason elementet e subjektit që paraqesin veprat e artit; - Vlerëson veprat duke renditur karakteristikat e veçanta dhe ato të përbashkëta. Kriteret e suksesit: - Përshkruan dhe krahason atë që sheh te dy vepra arti. - Rendit karakteristikat e veçanta dhe të përbashkëta të dy veprave të artit.			

3 Ky model mësimi, me rrugën metodike që ndjek, shërben për të krahasuar dy punime të nxënësve në klasë apo edhe vepra të tjera të artit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Edukatë figurative 3, imazhet e dy veprave të artit që kanë elemente të përbashkëta të subjektit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuha dhe komunikimi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, përshkrimi

Mësuesi/ja shfaq imazhet e dy veprave që kanë karakteristika të përbashkëta të subjektit. Në libër janë marrë si shembull: “Çerdhja”, 1979, e piktorit Isak Asllani dhe “Pëllumbat”, 1984, e piktorit Fevzi Tufekçi. Nxënësit ftohen të përshkruajnë subjektin e veprës së artit, pra atë që është e dukshme, nëpërmjet pyetjeve orientuese të mësuesit/es.

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, analiza dhe krahasimi

Mësuesi/ja rendit të gjitha të dhënat e vëzhgimeve duke krijuar një listë. Mësuesi/ja ndërton në tabelë diagramin e Venit dhe i fton nxënësit të përzgjedhin dhe të vendosin karakteristikat e veçanta dhe të përbashkëta. Këtë detyrë nxënësit e realizojnë në fletoren e punës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: vlerësimi, diagrami i Venit

Në fund të orës, nxënësit lexojnë ndarjen e karakteristikave të veçanta dhe të përbashkëta. Më pas i diskutojnë me njëri-tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi i nxënësve do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- Në vlerësimin e punës së secilit nxënës, në mënyrën e realizimit të detyrës dhe analizës vlerësuese që nxënësit iu bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kjo detyrë mund të zhvillohet edhe te *Fletorja e punës*.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

REFERENCA

- *Kurrikula lëndore/programi mësimor: Edukatë figurative 3; Republika e Kosovës, gusht, 2018.*
- *Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës, fusha e kurrikulës Artet; Instituti Pedagogjik i Kosovës; Republika e Kosovës, mars 2014.*
- *Eileen S. Prince, Art Is Every Day, Activities for the Home, Park, Museum, and City, Zephyr Press, Chicago, 2012.*
- *Al Hurwitz & Michael Day, Children and Their Art: Methods for the Elementary School, Eighth Edition, Thomson Wadsworth, USA, 2007.*
- *Eileen S. Prince - Art is Fundamental. Teaching the Elements and Principles of Art in Elementary School; Zephyr Press, Chicago, 2008.*
- *Eileen S. Prince - Art Matters: Strategies, Ideas, and Activities to Strengthen Learning Across the Curriculum; Zephyr Press, Chicago, 2002.*
- *Rob Barnes - Teaching Art to Young Children 4-9; Routledge Falmer, London and New York, 2002.*
- *Angela Wenzel - 13 Art Techniques Children Should Know; Prestel Publishing, Munich-London- New York, 2013.*
- *Gaitskell, Charles D., Hurwitz, Al, Day, Michael - Children and Their Art: Methods for the Elementary School; Harcourt College Publishers, 1982.*
- *Rudolf Arnheim - Arte e percezione visiva; Feltrinelli Editore, 1994.*
- <https://teachbesideme.Com/kee-art-lesson/>
- <https://kinderart.Com/category/art-lessons/painting/>
- <https://www.Artic.Edu/artworks/20684>
- https://en.Wikipedia.Org/wiki/a_sunday_afternoon_on_the_island_of_la_grande_jatte
- *Fotografite e marra nga faqja: https://www.dreamstime.com/*

